

GAZETA SHQIPTARE



Kryeredaktor: Erl MURATI
Zv/kryeredaktore - Rezarta DELISULA
Tel:(04)2359-104, Fax:(04) 2359-116 E-mail:gazetashqiptare@hotmail.com



Viti XXVI - Nr. 7774 E shtunë 26 Janar 2019 Çmimi, 50 lekë (1.5 euro)

Opinion

Ditës

Nga BERAT BUZHALA

Elexova - me shqetësim - komunitetin e Shteteve të Bashkuara të Amerikës, drejtuar bartësve të institucioneve të Kosovës, por që, në mes të tjerash, u ishte...

Vijon në faqen 21

Kosova duhet të flasë gjermanisht



Opinion

Ditës

Nga REXHEP QOSJA

Një fund dhe një fillim. Këtë vit, 2019, e shënojmë 100-vjetorin e ndarjes nga jeta të Babait të Pavarësisë së Shqipërisë, Ismail Qemalit. Ai është personalitet me rëndësi... Vijon në faqen 20

Ismail Qemali shembulli historik



“Na përfaqëson brenda e jashtë vendit”

Qeveria njofton ambasadat: Çakaj do ketë atributet e ministrit të Jashtëm

Gjykata Kushtetuese, “peng” i Këshillit të Drejtësisë, bllokimi zgjat dhe 4 muaj

Dak ditë më parë në një ceremoni të posaçme kryeministri dhe ministri i Jashtëm për Evropën dhe Punët e Jashtme i kaloi publikisht dhe ligjërisht kompetencat e kryediplomatit, zëvendësministrit Gent Çakaj. “Unë i nënshkruari Edi Rama, në funksionin e Kryeministrit të Republikës së Shqipërisë dhe Ministrit për Evropën...

Në faqen 3

NDERTIMET INFORMALE/ FAMILJET QE MARRIN LEJET NE 11 NJESITE BASHKIAKE

LEGALIZIMET NE TIRANE, 500 EMRAT E PERFITUESVE

ALUIZNI: Lista e re e personave që legalizojnë shtëpitë. Procedura për marrjen e tapisë ndiqet nga Agjencia. Sipërfaqja, jo më e madhe se 500 m²



(Në foto) Foto ilustruese

Në faqen 10-11

“ESKOBARI”

Klement Balili kërkon gjykim të shkurtuar, akuzë për 4 vepra penale

Në faqen 5

TIRANE

Denoncimi i PD-së: Te Presidencia, leje për kullë pronarit të lojërave të fatit

Në faqen 4

EKONOMI

Gjopa bizneseve që nuk deklarojnë ndryshimet në trupën aksionere

Në faqen 9

MARREVESHJA

33 dokumente tani do të merren nga “E-Albania”, si të evitoni rradhët

Në faqen 8

ITALI



Shkatërrohet banda e shqiptarëve që kishte lidhje me “Ndrangheta”-n

Në faqen 6



Reperi i njohur dhe modelja, dyshimet e zënkës. Ç’thonë fansat

“Sherr” në OTR? Noizy dhe Oriola prishin raportet

“Habit” Arjola Shehu: Kam fjetur me 2 VIP-a. Xhesika Muçaj: Ëndrra, realitet

Nga PAMELA ALIAJ

Grupi OTR është një nga grupet më të përfolura në vend dhe kjo jo vetëm për shkak të kreut të saj, reperit Noizy, por edhe për shkak të modeleve bukuroshe që janë pjesë e tij. Një ndër to është edhe bukurshja Oriola Mar-



ashi. Ajo është padyshim femra më e bukur shqiptare duke veçuar edhe asetet e saj. Modelja shqiptare u bë e njohur falë reperit, Noizy e cila u bë bashkëpunëtoreshë në grupin e tij “OTR” e së fundmi e kemi parë edhe në klipet e tij. Oriola pati...

Suplement

DEKRETET NGËRÇI

Gjykata Kushtetuese mbetet peng i KED dhe propozimit të kandidatëve nga institucionet

Kriza Rama-Meta, Kushtetuesja mund të ngrihet vetëm pas 3-4 muajsh

Pas ngritjes ajo do marrë në shqyrtim padinë e PS

Kryeministri Edi Rama do duhet të drejtojë Ministrinë për Europën dhe Punët e Jashtme me zëvendësministrin Gent Cakaj të paktën edhe disa muaj të tjerë. Kjo pasi Gjykata Kushtetuese, tek e cila ai shpreson se do të zgjidhë konfliktin e kompetencave me Presidentin e Republikës, Ilir Meta, nuk do mund të ngrihet të paktën deri nga fundi i prillit. Burime nga mazhoranca kanë bërë me dije se çdo gjë varet nga Këshilli i Emërimeve në Drejtësi (KED) dhe nga institucionet që kanë detyrimin të propozojnë kandidatët për anëtarë të Gjykatës Kushtetuese, më konkretisht Kuvendi, Presidenti dhe Gjykata e Lartë. Kushtetuta përcakton se Gjykata Kushtetuese përbëhet nga 9 anëtarë, nga të cilët tre anëtarë emërohen nga Presidenti i Republikës, tre anëtarë zgjidhen nga Kuvendi dhe tre anëtarë zgjidhen nga Gjykata e Lartë. Hapi i parë nga KED është hedh, pasi ai u konstituua javën e shkuar, ndërsa tashmë pritet të miratohet Rregullorja mbi të cilën ai do të veprojë dhe ku do të përcaktohen mënyra e pikëzimit të kandidatëve për anëtarë në institucionet e drejtësisë, përfshi edhe Gjykatën Kushtetuese. Ndërkohë që Kuvendi, i cili ka të drejtën të propozojë kandidatët për tre vakanca të krijuara në Gjykatë Kushtetuese, mësohet se e ka përmbyllur procesin e përzgjedhjes së kandidatëve. Burime nga Kuvendi kanë bërë të ditur se është mbyllur procesi i pranimit të aplikimeve dhe shprehjes së interesit nga kandidatët të ndryshëm, dhe se KED i janë dërguar kandidaturat edhe për pozicionin e fundit të lënë vakant pas largimit të Bashkim Dedes. Ndërkohë që edhe Presidentia, e cila ka detyrimin të propozojë emrat për dy vende të tjera të mbetura vakant në këtë gjykatë ka përfunduar, gjithashtu, procesin e marrjes së aplikimeve dhe i ka dërguar ato në KED. Për vendin e mbetur vakant pas shkarkimit të Altina Xhoxhaj, thirrjes së Presidentit iu përgjigjën tre kandidatë të cilët janë: Prel Martini, Sinan Tafaj dhe Ardita Buna (Alsula). Ndërkohë që pas në këtë proces mbetet Gjykata e Lartë, së cilës iu desh që të rihap procedurën e thirrjes për aplikime të reja, pasi në thirrjen e parë nuk pati kandidat. Nuk dihet ende nëse në këtë thirrje të dytë që ka përfunduar në fund të dhjetorit a ka pasur aplikantë ose jo, por në faqen zyrtare të Gjykatës së Lartë nuk janë shpallur kandi-



KUSHTETUTA

■ **Neni 12516**

1. Gjykata Kushtetuese përbëhet nga 9 anëtarë. Tre anëtarë emërohen nga Presidenti i Republikës, tre anëtarë zgjidhen nga Kuvendi dhe tre anëtarë zgjidhen nga Gjykata e Lartë. Anëtarët përzgjidhen ndërmjet kandidatëve të renditur në tri vendet e para të listës nga Këshilli i Emërimeve në Drejtësi, sipas ligjit.
2. Kuvendi zgjedh gjyqtarin e Gjykatës Kushtetuese me jo më pak se tri të pestat e të gjithë anëtarëve të tij. Nëse Kuvendi nuk zgjedh gjyqtarin brenda 30 ditëve nga paraqitja e listës nga Këshilli i Emërimeve në Drejtësi, kandidati i renditur i pari në listë shpallet i emëruar.
3. Gjyqtarët e Gjykatës Kushtetuese qëndrojnë në detyrë për 9 vjet, pa të drejtë riemërimi.
4. Gjyqtarët e Gjykatës Kushtetuese duhet të kenë arsim të lartë juridik, të paktën 15 vjet përvojë pune si gjyqtarë, prokurorë, avokatë, profesorë ose lektorë të së drejtës, nëpunës të nivelit të lartë në administratën publike, me një veprimtari të shpikuar në fushën e së drejtës kushtetuese, të drejtave të njeriut ose në sfera të tjera të së drejtës.



Kryeministri Edi Rama dhe zëvendësministri i Jashtëm Gent Cakaj

Meta në Skrapar: Sakrifica e dëshmorëve, na ndriçon drejt BE-së

Presidenti i Republikës, Ilir Meta ishte dje në Nishicë të Skraparit për të përkujtuar përmes një ceremonie të veçantë një prej ngjarjeve më të lavdishme, 75-vjetorin e betejës madhështore të Tendës së Qypit, nga 20-26 janari i 1944, që paralajmëroi dimrin e fundit të pushtuesve. Presidenti shkruan në 'Facebook' se kujtoi 17 dëshmorë e partizanë të Brigadës së Parë Sulmuese dhe Grupit të Skraparit dhe tha se gjaku i tyre i derdhur çlirimin e Atdheut ju vetëm lartësoi Shqipërinë në koalicionin botëror anti-fashist, por sakrifica e heronjve edhe sot e kësaj dite shërben për të ndriçuar rrugën e shqiptarëve drejt BE. "Lavdi përjetë 17 dëshmorëve partizanë të Brigadës së Parë



Sulmuese dhe Grupit të Skraparit, që u drejtua trimërisht nga Heroi i Popullit, Zylfyt Veslhija. Gjaku i derdhur për çlirimin e Atdheut, ju vetëm nderoi dhe lartësoi Shqipërinë në koalicionin botëror anti-fashist, por na shpëtoi nga copëtimi dhe

moskzistenca. Ndaj sakrifica sublime dhe vepra e ndritur e heronjve dhe dëshmorëve tanë, meriton përulje e nderim nga të gjithë ne, pasi shkëlqen edhe sot duke na ndriçuar rrugën për të ardhmen europiane", shprehet z.Meta.

Politika shqiptare përshëndet miratimin e marrëveshjes së Prespës nga parlamenti grek

Politika shqiptare u bë dje bashkë tekta përshëndeti ratifikimin e marrëveshjes së Prespës për ndryshimin e emrit të Maqedonisë. I pari që reagoi ishte ish-ministri i Jashtëm, Ditmir Bushati, i cili përmes një postimi në Twitter, shkruan se vota e parlamentit grek zgjidhi mosmarrëveshjen 27 vjeçare mbi çështjen e emrit të Maqedonisë dhe i hapi dyert asaj për pranimin në BE dhe NATO. "Ky është një moment historik për Ballkanin", shkruan Bushati. Ndërsa një lajm të shkëlqyer e cilësoi presidenti i Shqipërisë, Ilir Meta. Në 'Facebook', Meta përgëzoi dy shtetet për arritjen historike. "Miratimi i Marrëveshjes së Prespës edhe nga Parlamenti grek është një lajm i shkëlqyer për marrëdhëniet dypalëshe me Maqedoninë e Veriut dhe për perspektivën europiane dhe euro-atlantike të rajonit tonë! Përgëzime për këtë arritje historike!" shkruan Presidenti. Kryeministri Edi Rama në Twitter shkruan: "Respektim dhe urim për Aleksis Tsipras dhe Zoran Zaev për arritjen e tyre historike dhe fundin e konflikteve të gjata midis Greqisë dhe Maqedonisë së Veriut". Votimi u përshëndet edhe nga kreu i Kuvendit, Gramoz Ruçi, i cili e quajti një veprim kurajoz të Greqisë. "Votimi, nga një parlament vizionar: Ballkani po çlirohet nga incertitë shekullore", tha Ruçi. Edhe kreu i PD, Lulzim Basha tha se marrëveshja konsolidon bazat e bashkëpunimit për paqen dhe stabilitetin e rajonit. "Përshëndes ratifikimin e marrëveshjes së Prespës nga parlamenti helen që i hap rrugën anëtarësimit në NATO të Maqedonisë së Veriut dhe konsolidon bazat e bashkëpunimit për paqen dhe stabilitetin e rajonit," shkruajti ai.

pa e gjyqtarëve do të marrë kohën e vet për të gjykuar mbi konfliktin e kompetencave mes presidentit dhe kryeministrit. Deri atëherë Rama do duhet të qeverisë me zëvendësministër ose të propozojë një emër tjetër por të konsultuar paraprakisht me presidentin Meta.



Pas largimit të Gjijnurit, Rama largon edhe zëvendësministrin

Vala e shkarkimeve në ekzekutiv ka vijuar edhe në nivele më të ulëta. Pas largimit të rreth 70 për qind të anëtarëve të Kabinetit Qeveritar, kryeministri Edi Rama ka vijuar të ndryshojë edhe nivelet e tjera të qeverisjes. Ditët e fundit kemi parë disa largime të drejtorëve të rëndësishëm, ndërsa të enjten ka ardhur edhe largimi i zëvendësministrin të Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjetikës. Pasi largoi nga detyra, Damian Gjijnurit, më datë 23 janar, Rama ka firmosur shkarkimin nga detyra edhe të zëvendësministrin të Infrastrukturës dhe Energjisë, Enis Aliko. Vendimi nuk është publikuar në faqen e Kryeministrit, por ky vendim është bërë publik pasi është botuar në Fletoren Zyrtare. Ndërkohë që Edi Rama ka vendosur të rikthejë në detyrën e zëvendësministrin të Infrastrukturës dhe Energjisë, ish-deputetin e Elbasanit, Ilir Bejtja. Ky i fundit ishte këshilltar i Gjijnurit në Ministrinë e Infrastrukturës. Ai me parë ka qenë edhe deputet i PS-së për qarkun e Elbasanit.

Zguri: KQZ do bëj maksimumin, të mos ndryshohen komisionerët

Ndryshimet në Kodin Zgjedhor, në rast se do të mira tohen nga parlamenti brenda afati të ri të vendosur për Komisionin e Posaçëm të Reformës Elektorale, do jenë thujtë të pamundura për t'u zbatuar në praktikë. Kjo pasi KQZ do e ketë thujtë të pamundur që të përmbushë detyrimet ligjore që kanë të bëjnë kryesisht me teknologjinë apo edhe depolitizimin e komisioneve të niveleve të treta dhe të dyta të administrimit të zgjedhjeve. Por gjithsesi kryetari i KQZ-së, Klement Zguri deklaroi se nga ana e këtij institucioni nuk do të mungojë vullneti për të përmbushur detyrimet që do lindin. "Nëse ligjvënës do të ketë arsye dhe do të merret vesh për të bërë ndërhyrje e ndryshimet e duhura në Kodin Zgjedhor, që synojnë përmirësimin e përgatitjeve për procesin zgjedhor, KQZ-ja do të bëjë maksimumin e vet që këto ndryshime të realizohen dhe të shkojnë në funksion të qëllimit", - tha Zguri. Ndërkohë që ai shprehu shqetësimin për zëvendësimin në mënyrë të vazhdueshme të komisionerëve nga ana e partive politike. Për këtë ai tha se nëse partitë nuk arrijnë t'i depolitizojnë, të paktën të vendosin që të mos i zëvendësojnë.

Ministria e Jashtme informon ambasadorët dhe diplomatët me ndryshimet në qeveri

MEPJ letër përfaqësive diplomatike për të njohur Cakajn si ministër

Genti Cakaj ende pa CV në faqen zyrtare

Pak ditë më parë në një ceremoni të posaçme kryeministri dhe ministri i Jashtëm për Evropën dhe Punët e Jashtme i kaloi publikisht dhe ligjërisht kompetencat e kryediplomatit, zëvendësministrin Genti Cakaj. "Unë i nënshkruari Edi Rama, në funksionin e Kryeministrit të Republikës së Shqipërisë dhe Ministrit për Evropën dhe Punët e Jashtme, i delegoj zotit Genti Cakaj, zëvendësministrin për Evropën dhe Punët e Jashtme, detyrën e drejtimit të Ministrisë për Evropën dhe Punët e Jashtme dhe përfaqësimit të Ministrit për Evropën dhe Punët e Jashtme, brenda dhe jashtë vendit", - do të lexonte shkurt kryeministri Rama atë ditë, ndërsa i dha Cakës edhe urdhrin e kalimit të kompetencave. Rama përmbushi kështu idenë e tij për t'i dhënë Cakajt drejtimin e Ministrisë për Evropën dhe Punët e Jashtme, megjithëse jo si ministër, por si zëvendësministr. Ndërkohë që nëpërmjet delegimit të kompetencave në mënyrë demonstrative Rama përcilloi tek të gjithë mesazhin se tashmë personi me autoritetin e plotë për të vepruar si ministër i Jashtëm, ishte pikërisht Cakaj. Menjëherë pas këtij momenti Ministria e Jashtme ka nxituar që të informojë mbi këtë ndryshim edhe të gjithë përfaqësuesit e huaja dhe nëpërmjet tyre edhe shtetet përkatëse që ato përfaqësojnë. Kështu, nëpërmjet një letre zyrtare drejtuar gjithë ambasadave dhe niveleve të tjera të përfaqësimit diplomatik të akredituara në vendin tonë, Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme, ka informuar diplomatët mbi ndryshimet qeveritare të ndodhura në vendin tonë. Ndërmjet të tjerave tekta rendit gjithë ministrat e rinj që janë bërë pjesë e kabinetit qeveritar ministria e vëzhgimit dhe faktin se si ministër i Jashtëm me kompetencat të deleguara do jetë pikërisht Genti Cakaj. "Gjithashtu, prej datës 23 janar 2019, Kryeministri dhe Ministri për Evropën dhe Punët e Jashtme, SH.T.Z, Edi Rama, i delegon zyrtarisht zotit Genti Cakaj kompetencat e plota të ministrit për drejtimin e Ministrisë për Evropën dhe Punët e Jashtme dhe përfaqësimit të ministrit për Evropën dhe Punët e Jashtme në emërimin e



Faksimile e letres së dërguar ambasadave

LETRA

"Gjithashtu, prej datës 23 janar 2019, Kryeministri dhe Ministri për Evropën dhe Punët e Jashtme, SH.T.Z, Edi Rama, i delegon zyrtarisht zotit Genti Cakaj kompetencat e plota të ministrit për drejtimin e Ministrisë për Evropën dhe Punët e Jashtme dhe përfaqësimit të ministrit për Evropën dhe Punët e Jashtme brenda dhe jashtë Republikës së Shqipërisë"

Rama letër diasporës: T'i qasemi sa më kthjellët sfidave të botës

Shqipëria do të presë më 28 shkurt deri në 2 mars Samitin e Dytë të Diasporës që do të mbahet në Tiranë. Për të siguruar një përfaqësim sa më të madh dhe sa më cilësor, kryeministri, Edi Rama u ka nisur një ftesë të gjithë shqiptarëve që jetojnë dhe punojnë në diasporë. Për të marrë pjesë në Samitin e Dytë të Diasporës. "Kjo është një letër për ju, sikundër është edhe mirëfilli një ftesë. Në kuadrin e 575-vjetorit të Kuvendit të Lezhës, do të mbahet Samiti i II i Diasporës shqiptare. Samiti është një ngjarje e pashoq. Ai është dëshmi e refuzimit të mbylljes në vetvete dhe e vullnetit për të bashkuar forcat kundruall sfidave të shekullit dhe epokës sonë. Samiti është udhërrëfyesi, i cili, pavarësisht larmisë së bindjeve vetjake dhe vendndodhjes së gjithse-



cilit, na jep dorë ne, si shqiptarë, të qasemi sa më kthjellët sfidave të botës të cilën jetojmë, trysnisë së teknologjive të informacionit dhe komunikimit, si edhe mënyrave të duhura dhe organizimit mes nesh, në përputhje me kohën. E ardhmja e kombit nuk farkëtohet sipas modeleve të parapërgatitura apo në bazë receptash cudibërëse", - shkruan Rama në letërën e tij. Më tej ai thekson se tjetërsimi i së

vërtetës, keqpërdorimi i historisë, vetëmashtrimi për arsye ngushëllimi apo rehatie, nesër do ta bëjë bashkëjetesën më të vështirë. "Analiza lidhur me dukuritë migratore duhet të na bëjë edhe më të ndjeshëm dhe të qartë duke kuptuar njëherazi se proceset integruese, ai evropian në veçanti, janë sfida madhore për vetë mënyrën tonë të jetesës", - shkruan Rama.

Evropën dhe Punët e Jashtme brenda dhe jashtë Republikës së Shqipërisë", - theksohet në letërën që Ministria e Jashtme u ka dërguar gjithë ambasadave dhe përfaqësive tona diplomatike nëpër botë. Por pavarësisht kësaj në faqen zyrtare të Ministrisë për Evropën dhe Punët e Jashtme është ndryshuar tashmë përberja dhe në pozitën e ministrit është vendosur

pikërisht foto dhe disa të dhëna të shkurtra të Edi Ramës. Ndërkohë që Cakaj vijon të mbetet në kategorinë e zëvendësministrave, por pa një foto dhe pa një CV të të dhënave të tija. Cakaj u vu në qendër të një lufte dhe konflikti institucional mes Presidentit të Republikës, Ilir Meta dhe Kryeministrit, Edi Rama. Meta nuk pranoi ta dekretojë emërimin e

Cakaj si ministër duke argumentuar se ndërmjet të tjerave ai kishte shkelur ligjin duke mos u pajisur me certifikatë sigurie dhe se kishte promovuar në deklaratat e tija korrigjimin dhe ndarjen e kufijve të Kosovës. I gjendur në këto kushte, kryeministri Rama zgjodhi që ta marrë vetë postin de juro ndërsa de facto ia la detyrën Cakaj.

OPOZITA AKUZAT

Valentina Madani

Partia Demokratike kërkoi dje hetim për kryeministrin Edi Rama dhe kreun e Bashkisë së Tiranës, Erion Veliaj për pastrim parash. Sipas demokratëve, brenda 7 muajve, ata i kanë dhënë 3 leje ndërtimit pronarit të kompanisë më të madhe të bixhozit në vend. Në një deklaratë për mediat, zëdhënësja e PD-së, Ina Zhupa i cilëson të pamjaftueshme hetimet e nisura nga KKT, për lejen e ndërtimit mbrrapa Presidencës. Sipas saj, pjesë e hetimit duhet të jetë edhe kryeministri Rama e kryebashkiaku Veliaj. "Brenda 7 muajve, ata i kanë dhënë 3 leje ndërtimit pronarit të kompanisë më të madhe të bixhozit në vend. Në tria ndërtimet në zonat më të mira dhe më të shtrenjta të Tiranës i janë dhënë një personi, Dajlan Avdia, pronar deri pak kohë më parë i kompanisë më të madhe të bixhozit 'Apex', - tha Zhupa. Ndër të tjera zëdhënësja e PD-së u shpreh se do të jenë hetimet ato që do të vërtetojnë se akuzat në media se pas lejes së 3 kullave në Tiranë fshihet vëllai i kryeministrit Olsi Rama. Sipas saj, "Hetimet do të verifikojnë akuzat në media se pas lejes së 3 kullave në Tiranë fshihet vëllai i kryeministrit Olsi Rama". "Të tria kullat do të zënë një sipër-

PD: Rama-Veliaj të hetohen për pastrim parash, 3 leje për kulla në mes të Tiranës

Denoncimi, PD: Biznesmeni që po ndërton kullë pas Presidencës

"Pas bosit të bixhozit, fshihet vëllai i Ramës"



Zëdhënësja e PD-së, Ina Zhupa

faqe prej 54 mijë metrash katrorë, thënë ndryshe sa 6 fusha të mëdha futbollit, të dhëna për një person, që sipas denoncimeve të medias, ka lidhje të drejtpërdrejta me vëllain e kryeministrit Olsi Rama. Edi Rama duhet t'u thotë shqiptarëve çfarë ka të veçantë Dajlan Avdia, i cili nuk ka pasur kurrë më

parë aktivitet ndërtimi, që i dha brenda pak muajve leje ndërtimi në 3 zonat më të shtrenjta të Tiranës, duke shkelur edhe ligjin. Njëra në nëntor 2017 në zemër të Bllokut. Një tjetër në shkurt të këtij viti tek Kulla e Sahatit. Për kullën e tretë leja u dha në muajin qershor, pak pasi klienti i Edi Ramës

shiti aksionet e bixhozit. Kjo është kulla që po ndërtohet mbrrapa Presidencës dhe për të cilën po heton prokuroria", deklaroi zh.zhupa. Ajo mbylli akuzat e saj duke thënë: "Kohës së përdorimit të kryeqytetit si lavatrice e pastrimit të parave të pista nga Edi Rama dhe Erion Veliaj po i vjen fundi!

AKUZA

Sipas demokratëve, brenda 7 muajve ata i kanë dhënë 3 leje ndërtimit pronarit të kompanisë më të madhe të bixhozit në vend. Në një deklaratë për mediat, zëdhënësja e PD-së, Ina Zhupa i cilëson të pamjaftueshme hetimet e nisura nga KKT për lejen e ndërtimit mbrrapa Presidencës.

Qytetarët po ngrihen në protestë së bashku me opozitën! Duke bashkuar zërin në protestat tona në Tiranë dhe në të gjithë Shqipërinë, ne mund t'i japim fund modelit që punon për pasurimin e një grushti klientësh të pushtetit dhe kundër interesit të qytetarëve".



Dorëheqja, Salianji: Në PD s'jam kokë turku

Dorëheqja, Salianji: Në PD s'jam kokë turku Deputeti i PD, Ervin Salianji shprehet se nuk e konsideron veten "kokë turku" teksa shpjegon arsyet e dorëheqjes se tij nga posti i sekretarit të grupit të PD. Për "Politika online" në "Gazetën Shqiptare", ai lidh dorëheqjen nga posti me mosarritjen e pritshmërive të tij në votimin e brendshëm partiak. "Kam hyrë në politikë për të bërë një politikë ndryshe, jam për një rifreskim jo vetëm të emrave, por dhe detyrave që qarkullojnë në politikë. Njerëzit nuk mund të rrijnë prej vitesh në politikë pa marrë përgjegjësi, sidomos kur nuk ka rezultate apo kur nuk arrihet një objektivi. Unë kam pretenduar në garën brenda partisë, për shkak të aktivitetit që kontributi i dhënë në opozitë të vlerësohej me votë në një masë më të madhe. Duke qenë se nuk arrita objektivin që kisha vendosur në mënyrë personale vendosa të largohem", tha Salianji.

"Fillon një seri e re, s'ka kthim pas"

Paloka: Nuk synojmë pushtet me protesta, por zgjedhje të lira



Nënkryetari i PD-së, Edi Paloka

Sipas tij, PD nuk kërkon marrjen e pushtetit me protesta. "Synimi - sqaron Paloka - është realizimi i zgjedhjeve të lira dhe të ndershme, me një qeveri tranzitore pasi me Edi Ramën kryeministër është e pamun-

dur. Synimi që ne kemi është realizimi i zgjedhjeve të lira dhe të ndershme. Nuk ka synim marrjen e pushtetit me protesta. Në funksion të kësaj do të formatohet dhe qeveria që ne kërkojmë. Por nuk mund t'ju them një for-



FLAMUR NOKA

Deputeti i PD-së tha se shqiptarët cep në cep janë në revoltë me qeverinë që mbahet me hajdutëri. "Shqipëria është vendosur në tepsit dhe po 'hahet' nga banda e Ramës. Vetëm një qeveri tranzitore mund të kthejë besimin tek vota", - deklaroi Noka.

mulë, do të jetë e përbërë nga demokratë nga socialistë apo teknikë. E vetmja gjë që kemi të qartë është që sa të jetë Edi Rama zgjedhje të lira ne nuk do të bëjmë", - theksoi z.Paloka.



LSI, Vasili: Pastrim i madh parash në vend, DASH dha alarmin

Kryetari i grupit parlamentar të LSI-së, Petrit Vasili, shprehu dje shqetësimin se partnerët e huaj kanë dhënë tashmë alarmin se në Shqipëri pastrohen para të pista, duke kërkuar reagimin e shqiptarëve dhe bashkimin në protestën për rrëzimin e Ramës. Vasili reagoi me anë të një deklaratë për shtyp në lidhje me publikimin nga autoritetet policore gjermane të një libri me titull: "Partner kriminel në aleancën strategjike", që përmban fakte tronditëse dhe alarmante për pastrimin e parave të pista në Shqipëri. Sipas Vasilit, pastrimi kriminal i parave bëhet vetëm për pasurimin e kryeministrit Rama dhe klikës së tij, ndërkohë që shumica e shqiptarëve zhyten në varfëri dhe mjerim. "Departamenti Amerikan i Shtetit, ka tundur kambanat e alarmit, pasi paratë pastrohen haptazi dhe përshkruan dhe se ku ndodh ky pastrim parash. Njëherazi evidentohen, po nga raportet edhe të Policisë Gjermane, por dhe të Këshillit të Europës dhe të DASH, edhe çarjet në sistemin financiar shqiptar", - tha Vasili.

TIRANË

47-vjeçari akuzohet për 4 vepra penale, nëse shpallet fajtor, përfiton uljen e 1/3 të dënimit

Dhjetë ditë pas vetë dorëzimit, Gjykata e Shkallës së Parë për Krime të Rënda ka nisur procesin ndaj Klement Balilit, të ashtuquajturit "Eskobari i Ballkanit". Brenda këtij harku të shkurtër kohor, 47-vjeçari i shumëpërfolur gjatë dy viteve të fundit është njohur me masën e sigurisë dhe ka përfunduar në gjykatë si i pandehuri. Ndërkohë, gjatë seancës paraprake që u zhvillua ditën e djeshme, Balili dhe avokati i tij mbrojtës, Theodhori Sollaku kërkuan gjykim të shkurtuar. Kërkesa është depozituar dhe në sekretarinë e gjykatës, ndërsa gjyqtarja e çështjes, Miliana Muça, vendosi të kalojë për gjykimin dosjen. Seanca filloi në orën 12:00 pa praninë e Klement Balilit dhe për shkak të kërkesës në fjalë, gjykata shlyu seancën për të rifilluar në orën 13:30. Kjo me qëllim që i pandehuri të ishte vetë prezent në sallën e gjyqit. Seanca ka përfunduar në orën 14:00. Pas transferimit të Balilit në sallën e gjyqit, ai është pyetur nga gjyqtarja lidhur me kërkesën e gjykimin të shkurtuar të kryer nga avokati Sollaku, për të cilën ka konfirmuar dakordësinë e tij. Gjyqtarja Muça, pasi ka shqyrtuar kërkesën për gjykim të depozituar nga prokurori i çështjes, Ened Nakuçi, i ka cilësuar aktet hetimore të bëra për nisjen e shqyrtimit gjyqësor. Me praninë e kërkesës së prokurorisë, pritet që të caktohet edhe treshja gjyqësore që do të shqyrtojë çështjen, e cila do të vendosë për pranimin ose jo të kërkesës për gjykim të shkurtuar të kryer nga i pandehuri Klement Balili dhe avokati i tij. Do të jetë gjyqtarja Miliana Muça, e cila do vendosë seancën e ardhshme gjyqësore për këtë kërkesë të Balilit. Në bazë të veprave penale për të cilat akuzohet, Klement Balili rrezikon dënimin minimal me 7 vite heqje lirie dhe atë maksimal me 15 vite. Nëse gjykata do të pranojë gjykimin e shkurtuar, atëherë ai do të përfitojë uljen e një të tretës së dënimit. Prokuroria e Krimeve të Rënda ka ngritur 4 akuzat për Klement Balilin dhe konkretisht: "Trafik ndërkombëtar lëndësh narkotike, në bashkëpunim", "Pjesëmarrje në grupin e strukturuar kriminal", "Refuzim për deklaram, mosdeklarim, fshehje ose deklarim i rremë i pasurive", si dhe për "Pastrim parash", Klement Balili, i ashtuquajtur si "Eskobari i Ballkanit", "Baroni i drogës", "Peshku i madh" apo "Magjistari" i vetëdorëzua më 15 janar pas dy vitesh në kërkim. Ai ishte në arrati nga drejtësija greke që nga maji i vitit 2016, si kërkim i një grupi të strukturuar kriminal, që vepron në trafikimin ndërkombëtar të lëndëve narkotike. Balili ar-

10 ditë pas dorëzimit, "Eskobari i Ballkanit", Klement Balili kërkon gjykim të shkurtuar

Seanca te Krimet e Rënda, gjyqtarja Miliana Muça vendosi të pranojë çeljen e shqyrtimit gjyqësor

DËNIMI

Në seancën e ardhshme gjyqësore do të jetë gjyqtarja Miliana Muça, e cila do vendosë për kërkesën e bërë dhe nga Klement Balili dhe avokati i tij për gjykim të shkurtuar. Në bazë të veprave penale, për të cilat akuzohet Klement Balili, rrezikon dënimin minimal me 7 vite heqje lirie dhe atë maksimal me 15 vite. Nëse gjykata do të pranojë gjykimin e shkurtuar, atëherë ai do të përfitojë uljen e një të tretës së dënimit.



Klement Balili

AKUZAT NDAJ BALILIT

Klement Balili u dorëzua mëngjesin e 15 janarit pas 3 muaj negociatash mes drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit, Ardi Veliu dhe nipit të tij, Rigers Balili, me detyrë kryetar i bashkisë së Delvinës. Por, pavarësisht vetëdorëzimit edhe në prani të njërit prej familjarëve të tij, policia pretendon se 46-vjeçari nuk e përballoi dot presionin dhe rrethimin policor, të paktën gjatë dy muajve të fundit. 46-vjeçari akuzohet për "Trafik ndërkombëtar lëndësh narkotike, në bashkëpunim", "Pjesëmarrje në grupin e strukturuar kriminal", "Refuzim për deklaram, mosdeklarim, fshehje ose deklarim i rremë i pasurive", si dhe për "Pastrim parash".

DEKLARATA NË GJYQ

Më 17 janar, Klement Balili, i cili për më shumë se dy vite sfidoi nga arratia institucionet ligjzbatuese, doli i qeshur nga qella ku mbahej dhe po ashtu u shfaq në kafazin e xhamtë të Gjykatës për Krime të Rënda, ku dhe u zhvillua seanca gjyqësore për shqyrtimin e masës së sigurisë "Arrest me burg" marrë në mungesë për të. Biznesmeni që deri para disa ditëve ishte në toplotën e të kërkuarve të drejtësisë shqiptare ka mohuar në mënyrë kategorike akuzat, ndërsa deklaroi se është i pafajshëm në lidhje me katër veprat penale që rëndojnë mbi të. Ndërkohë, avokatët e tij mbrojtës, kanë sqaruar se për episodin, për të cilin e akuzon Prokuroria, Klienti i tyre nuk ka lidhje.

Tronditet Gjirokastra, shpërthim me tritol ndërtesës 3-katëshe

GJIROKASTËR - Një shpërthim i fuqishëm me tritol ka tronditur mbrëmë banorët e lagjes "Granicë e Sipërme" të Gjirokastës. Mësohet se ngjarja ka ndodhur në katin e parë të një vile 3-katëshe, në pronësi të një biznesmeni që mban dy emra, Ndërtim Muxhaj dhe Kleo Bello. Biznesmeni ka në pronësi një lavanderi (pastrim kimik). Nga shpërthimi nuk ka të lënduar, por janë dëmtuar muret dhe grilat e objektit në katin e parë të objektit që shërben si garazh. Nuk dihen ende shkaqet dhe motivet e ngjarjes. Forca policisë kanë shkuar në vendngjarje dhe kanë nisur hetimet. Pritet këyryra e kamerave të sigurisë së bizneseve si dhe marrja në pyetje e pronarit të objektit për të hedhur më shumë dritë për ngjarjen.

riti u shpëtojë 15 operacioneve policore. Ministri i Brendshëm, Sandër Lleshaj konfirmoi lajmin e dorëzimit në një konferencë për shtyp të martën e javës së shkuar, ndërsa u përpoq ta paraqesë dorëzimin si rrjedhojë e presionit policor.

HETIMI

Klement Balili akuzohet për trafikun e sasisë prej 678 kg kanabis sativa të papërpunuar. Sipas organit të akuzës, më 6 maj të 2016-ës, dy skafistë u nisën nga brigjet e Sarandës për të transportuar me skafin "Vasilikis" ngarkesën e kanabisit. Sipas dyshimeve, ata kanë komunikuar me Klement Balilin, i cili gjithashtu ka komunikuar edhe me një shtetas grekë për mënyrën se si do të zbarkohej droga në Zakynthos. Autoritet greke thonë se kanë identifikuar se numri me të cilin ka folur një prej skafistëve të arrestuar

është i Klement Balilit. Një fakt i tillë është kundërshtuar nga ky i fundit nëpërmjet avokatëve të tij. Ndërkohë, burime bëjnë me dije se në përgjigjen e kthyer nga autoritetet greke, ku janë edhe dëshmitë e dy skafistëve, nuk rezultoi se ata kanë implikuar Klement Balilin. Ndërkohë, nga vendimi i Gjykatës për Krime të Rënda, që caktoi masën e sigurisë "Arrest me burg" dy vite më parë, ekzistojnë disa përgjime. Konkretisht, numri që autoritet greke dyshojnë se ka qenë në përdorim të Klement Balilit është identifikuar gjatë bisedave me njërin prej skafistëve, ku ai thirrjet Kell. Referuar mediave greke në vitin 2016, ato kanë shkruar se në hetimet për zbardhjen e rrjetit të drogës ku pjesëtarë dyshohet të ketë qenë edhe Klement Balili, kanë marrë pjesë edhe agjentët e DEA-s amerikane.

Kërkoi rryshfet dhe favore seksuale, Apeli i Krimeve të Rënda lë në burg gjyqtarin Hysi

TIRANË - Apeli i Krimeve të Rënda ka lënë dhe në burg gjyqtarin e Fierit, Roland Hysi dhe psikologjen Elona Meçani, të përfshirë në një aferë korruptive të publikuar disa ditë më parë në një emision investigativ. Gjyqtari dhe psikologja që luante rolin e sekseres u arrestuan pas publikimit të denoncimit, ku gjyqtari shfaqej në një video teksa merrte rryshfet dhe i kërkonte favor seksuale një gruaje, që ishte në proces gjyqësor për të fituar kujdestarinë e vajzës. Ata akuzohen për "Korrupsion pasiv i



Roland Hysi

gjyqtarëve dhe prokurorëve", si dhe për "Ushttrim i ndikimit të paligjshëm të funksionarëve". Gjyqtari Hysi kërkonte hapur favore seksuale, si dhe sasi të konsiderueshme parash. Rasti që fundosi Roland Hysin u transmetua me zë dhe figurë

në emisionin investigativ "Stop", ku gjyqtari i kërkonte një nënë seks në këmbim të një vendimi në favor të saj. Situata shkoi deri aty sa në njërin prej takimeve të thirrura nga gjyqtari, ky i fundit i ka kërkuar gruas që ta prekë në pjesë intime.

SHPLLJE ANKANDI
Zyra Përmbarimore "E.G. Bailiff Service" me përmbareues gjyqësor Enuar Merko me adresë Rr. Ibrahim Ruvova, Pall 64, Hyrja B, Ap 1, Tiranë, njofton se më datë 22.02.2019 ora 8⁰⁰ - 16⁰⁰ në ambientet e saj, do të zhvillohet Ankandimi i llojeve të shpërthimit e pasurisë së paluajtshme. Anë, me sipërfaqe 13.000 m², Nr. pasurie 38/10, Zona Kadasbrale Nr. 1669, Vot 5, Fq. 202, në pronësi të Z. Behar Ibrahim. Filluar, do të zhvillohet Ankandimi i llojeve të shpërthimit e pasurisë së paluajtshme. Apartament me sipërfaqe totale 86.35 m², me numër pasurie 2/139/ND-1/13, volumni 71, faqe 142, zona kadastrale 85/18, me adresë Lagja 13, Plazh, Hyrja 1, Ap.13 Durrës, në pronësi të Z. Cilrim Sejfulla Xhafa dhe Znj. Bardha Xhemal Xhafa me vlerë fillestare në ankand 32.468 (Tridhjet e dy mijë e katërqind e gjashtëdhjet e tetë) EURO. Të interesuarit të kontaktojnë në nr. e telefonit 0672027580, +355 4 22 31 888. email enuar.merko@gmail.com

SHPLLJE ANKANDI
Zyra Përmbarimore "E.G. Bailiff Service" me përmbareues gjyqësor Enuar Merko me adresë Rr. Ibrahim Ruvova, Pall 64, Hyrja B, Ap 1, Tiranë, njofton se më datë 16.02.2019 ora 8⁰⁰ - 16⁰⁰ në ambientet e saj, do të zhvillohet Ankandimi i llojeve të shpërthimit e pasurisë së paluajtshme. Apartament me sipërfaqe totale 86.35 m², me numër pasurie 2/139/ND-1/13, volumni 71, faqe 142, zona kadastrale 85/18, me adresë Lagja 13, Plazh, Hyrja 1, Ap.13 Durrës, në pronësi të Z. Cilrim Sejfulla Xhafa dhe Znj. Bardha Xhemal Xhafa me vlerë fillestare në ankand 32.468 (Tridhjet e dy mijë e katërqind e gjashtëdhjet e tetë) EURO. Të interesuarit të kontaktojnë në nr. e telefonit 0672027580, +355 4 22 31 888. email enuar.merko@gmail.com

Njoftim për shitje me ankand te trete
Shoqëria "Power & Justice" (P&J) sh.p.k bazar në nenet 577, 568 të K.Pr.Chille ka shpallur në datë 21.01.2019 shitjen me ankand te trete te pasurise palese debitorre, hipotekuese dhe palese dorëzane.
■ "Toka Aro" në Z.K 1987 me numër pasurie 30/38 Volumni 19 Faqe 71, me sipërfaqe 1000 m² Lezhe me cmim fillestar prej 32.14 Euro
■ "Toka Aro" në Z.K 1987 me numër pasurie 40/56 Volumni 11 Faqe 92, me sipërfaqe 1730 m² Lezhe me cmim fillestar prej 90.332 Euro
■ "Toka Aro" në Z.K 1987 me numër pasurie 25/73 Volumni 15 Faqe 239, me sipërfaqe 2.000 m² Lezhe me cmim fillestar prej 88.301 Euro
Ankandimi qendron hapur për 30 ditë dhe do të zhvillohet në datën 20.02.2019 në orën 15:00, në sallën tone bazarit "Gj. Fishe" Kulla 1, Kat 2, Zyra nr. 5 kontakto 0672028453 ose email @_dovishaj@power.com dhe ne WEB _www.powerjustice.al.com

Prokurori i Elbasanit u confirmua në detyrë në nëntor 2018

ONM, kundër konfirmimit në detyrë të anëtarit të Këshillit të Lartë të Prokurorisë, Besnik Cani

TIRANË - Komisioneri Publik nuk ka rënë dakord me vendimin e Komisionit të Pavarur të Kualifikimit për prokurorin e Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Besnik Cani, i cili u confirmua në detyrë në muajin nëntor të vitit që shkoi, edhe pse ai pati probleme me justifikimin e pasurisë dhe për disa çështje që kishte hetuar. Aktualisht, Cani është anëtar i Këshillit të Lartë të Prokurorisë dhe këshilltar i Prokurorës së Përgjithshme të përkohshme, Arta Marku. Në njoftimin e tij, Komisioni Publik deklaroi se "në datë 27.11.2018, në përfundim të seancës dëgjimore përkatëse, Komisioni i Pavarur i Kualifikimit

u vendosi konfirmimin në detyrë të subjektit të rivlerësimit, z. Besnik Cani, me detyrë prokuror pranë Prokurorisë së Gjykatës së Rrethit Gjyqësor, Elbasan.

Në datë 25.1.2019, Komisioni i Pavarur i Kualifikimit u ka njoftuar Komisionerëve Publikë vendimin nr. 84, datë 27.11.2018, në lidhje me konfirmimin në detyrë të z. Besnik Cani, aktualisht anëtar i Këshillit të Lartë të Prokurorisë. Por në të njëjtën datë, 25.1.2019, Operacioni Ndërkombëtar i Mon-

itorimit u ka paraqitur Komisionerëve Publikë rekomandimin për të ankimuar në Kolegjin e Posaçëm të Apelit vendimin e Komisionit të Pavarur të Kualifikimit për konfirmimin në detyrë të z. Besnik Cani.

Rekomandimi i Operacionit Ndërkombëtar të Monitorimit është publikuar në faqen zyrtare të Institucionit të Komisionerëve Publikë: <http://ikp.al/rekomandime/> Komisionerët Publikë janë duke shqyrtuar vendimin e Kom-

sionit të Pavarur të Kualifikimit dhe rekomandimin e Operacionit Ndërkombëtar të Monitorimit.

Bazuar në pikën 1, të nenit 63, të ligjit nr. 84/2016, "Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë", Komisionerët Publikë, brenda 15 ditëve nga data e njoftimit të vendimit nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimit, kanë të drejtë të paraqesin ankim pranë Kolegjit të Posaçëm të Apelit.



Prokurori Besnik Cani

Institucioni i Komisionerëve Publikë është ngritur dhe funksionon në bazë të nenit 179/b dhe aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, dhe ligjit nr. 84/2016, "Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe

prokurorëve në Republikën e Shqipërisë".

Komisionerët Publikë përfaqësojnë interesin publik gjatë procesit të rivlerësimit kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë.

Policia e Viterbos ekzekuton 13 urdhër-arreste, pjesë e organizatës mafioze

ITALI

Policia e Viterbos ka ekzekutuar në orët e para të mëngjesit të djeshëm 13 urdhër-arreste për 13 persona të dyshuar si pjesë e një organizate mafioze, mes tyre edhe shqiptarë. Siç bëjnë me dije mediat italiane, 11 prej tyre do të lihen në burg dhe dy në arrest shtëpie. Ata akuzohen për pjesëmarrje në organizim të strukturuar mafioz, zhvatje e kërcënime të dhunshme, tentativa grabitje, dhunim fizik ndaj personave dhe armëmbajtje pa leje. Ky grup kriminal nën drejtimin e shqiptarit Isamil Rebeshi, i cili njihje me nofken "Ermal" dhe të italianit Giuseppe Trovato i thirrur "Peppino", anëtar i një prej klaneve të mafies kalabreze "Ndrangheta", kishte terrorizuar sipërmarrësit dhe banorët e Viterbos. Shqiptari Isamil Rebeshi është një person mjaft i njohur nga policia italiane e me disa precedentë penalë në trafikun e drogës. Ai është arrestuar

Shkatërrohet banda kriminale e lidhur me 'Ndrangheta'-n, një nga kapot është shqiptar

dhe në nëntor të 2018-ës me akuzën e trafikut të mbi 85 kg heroinë e kokainë nga Siria e Shqipëria drejt Italisë. Me anë të metodave mafioze, anëtarët e kësaj bande kishin vënë në kontroll Viterbon, ndërsa "gjahu" i tyre kryesor ishin sipërmarrësit dhe banorët e zonës, të cilët detyroheshin të paguanin gjoba. Kërcënimet e tyre në drejtim të bizneseve ata i dërgonin me letra kërcënuese e koka kafshësh. "Il Tempo", shkruan se hetimet e policisë italiane për këtë grup kanë nisur që në dhjetor të 2017-s. Operacionet antidrogë të kryera në disa vende të Europës, si në Itali, Spanjë, Holandë, Angli etj., dhe arrestimet e

Teste di agnello mozzate e attacchi incendiari, blitz contro la mafia viterbese: 13 arresti

Le indagini avviate a dicembre 2017 dai carabinieri del Nucleo investigativo e dalla Compagnia di Viterbo

di Valerio Di Corrado

25 Gennaio 2018



shumë shqiptarëve kanë bërë bujë në mediat ndërkombëtare, të cilat jo në pak raste kanë shkruar se ata janë kapot e trafikut të lëndëve narkotike. Por, mediat nuk kanë qëndruar thjesht në kuadrin e dhënies së informacionit, por disa prej tyre kanë publikuar dokumentare mbi të. Mbrëmjen e të martës në Itali, kanali "Tv Nove" ka transmetuar dokumentarin "Clandestino" të gazetarit investigativ spanjoll David Beriain mbi mafien shqiptare. Ai e përshkruan mafien shqiptare si "një organizatë brutale dhe efiçente, e cila e ka gjenëzën që në kohën e luftërave ballkanike. Në përshkrimin e

gazetarit, thuhet mes tjerash se mafia shqiptare fillimisht ka qenë në grupe të vogla, por zhvillimin e mori pas lidhjeve me qarqet politike. Kjo mbështetje sipas gazetarit investigativ i dha një hov "oreksit" të mafies shqiptare në trafikimin e drogës, armëve dhe qenieve njerëzore. "Lobi shqiptar është i mbyllur. Prej tij shumë pak dihet dhe për herë të parë hap derën për një gazetar", thekson ai. Ndërkaq, në një nga pjesët e dokumentarit transmetohet momenti kur një nga trafikantët pret në brigjet e Italisë një ngarkesë prej 5 kg kokainë, e cila ishte nisur nga Shqipëria dhe po transportohej me skaf.



REPUBLIKA E SHQIPERISE
BANKA E SHQIPERISE
DEPARTAMENTI I ADMINISTRIMIT
SEKTORI I PROKURIMIT

TENDER I HAPUR KOMBËTAR

Banka e Shqipërisë kërkon të realizojë objektin e prokurimit: "Sigurimi i jetës, kujdesit shëndetësor dhe sigurancion i shëndetit në udhëtim për punonjësit e Bankës së Shqipërisë, për një periudhë tre vjeçare"

"Banka e Shqipërisë fton kandidatët e interesuar, të marrin pjesë në procedurën e prokurimit "Tender i hapur kombëtar", për realizimin e objektit të prokurimit si më sipër, me fond limit 71,082,000 Lekë".

Dokumentet e tenderit mund të tërhiqen pranë Sektorit të Prokurimeve të Departamentit të Administrimit, të Bankës së Shqipërisë, me adresë: Rruga e Dibrës, Kompleksi "Hali", Kulla A, Tiranë, Tel. 042419411 (ext. 4251), çdo ditë nga ora 10.00 – 13.00 nga çdo person i autorizuar, me paraqitjen e një kërkesë me shkrim. Tërheqja e dokumenteve mund të bëhet vetëm pasi të kenë bërë paraparakisht pagesën e pakthyeshme prej 500 Lekë, pranë një banke tregtare në llogarinë e Bankës së Shqipërisë sipas detajeve të mëposhtme:

Përfutuesi: Banka e Shqipërisë
BIC: STANALTR
IBAN: AL68 1011 1008 0000 0000 2222 222L; BIC

Përshkrimi: Blerje dokumente tenderi për tenderin me objekt: "Sigurimi i jetës, kujdesit shëndetësor dhe sigurancion i shëndetit në udhëtim për punonjësit e Bankës së Shqipërisë, për një periudhë tre vjeçare"

Oferta duhet të paraqitet në zyrën e Sektorit të Prokurimeve, pranë Departamentit të Administrimit, në Bankën e Shqipërisë, deri më datë 18 Shkurt 2019, ora 11:00, kohë në të cilën do të hapet edhe tenderi, ku ftohen të marrin pjesë kandidatët ose përfaqësuesit e autorizuar të tyre.

U gjenden 52 kg drogë në makinë, arrestohen dy shqiptarë dhe një serb në Kosovë

KOSOVË - Dy shqiptarë dhe një serb janë prangosur mbrëmjen e së enjtes në Kosovë, pasi u kapën në flagrancë duke transportuar me makinë 52 kg marjuanë. Mësohet se arrestimi i tyre është kryer në rrugën Prishtinë-Gjilan. Aksioni i policisë së Kosovës ka nisur pas një hetimi disamujor, ndërsa për pos drogës u sekuestruan edhe dy makina, para, si dhe katër telefona celularë. "Gjatë realizimit të operacionit policor sot më 24.01.2019, rreth orës 16:00 në rrugën Prishtinë-Gjilan (në fshatin Ponesh) Policia e Kosovës ka ndaluar automjetin "Mercedes"



me targa shqiptare, që drejtohej nga i dyshuari (F.Th.), i cili ishte së bashku me të dyshuarin tjetër (Xh.H.), të dy meshkuj me shtetësi shqiptare dhe pas proceduarve të kontrollit në bagazhin e

automjetit në fjalë është gjetur një sasi prej mbi 52 kg, sasi e dyshuar e substancës narkotike e llojit marjuanë. Pas veprimeve të vazhdueshme operacionale taktike të njëjtën ditë (24.01.2019) rreth orës 19:30, në Gjilan (në parkingun e një qendre tregtare) është arrestuar i dyshuari i tretë (L.M.) me shtetësi serbe, i cili dyshohet se kishte për ta pranuar substancën narkotike të lartpërmendur. Policia gjatë këtij operacioni si prova materiale ka sekuestruar: Dy (2) vetura, katër (4) telefona celularë, dy mijë (2000) euro para kesh dhe mbi 52 kg marjuanë", njofton policia.



Studentet e UT-së dje gjatë bojkotit të mësimit

Deklarata me 5 pikat drejtuar Ramës: Kërkojmë rrëzimin e ligjit për arsimin e lartë

Voltiza Duro

Pedagogët e UT-së, ultimatum qeverisë: Keni afat 1 javë për plotësimin e kërkesave

"Nëse nuk reflektoni, do të futemi në grevë të përgjithshme"

Në një kohë që një pjesë e studentëve vazhdojnë bojkotin, ndërsa të tjerë i janë rikthyer auditorëve, qindra pedagogë të Universitetit të Tiranës kanë mbajtur një takim mbi kërkesat e të rinjve. Pedagogët kanë shprehur vullnetin e tyre për të përkrahur studentët dhe i kanë lënë qeverisë një javë afat për rrëzimin e ligjit për arsimin e lartë, në të kundërt do të nisnin grevë të përgjithshme. Të pranishëm në diskutim kanë qenë asambletë dhe stafet akademike të fakulteteve të Universitetit të Tiranës (Fakulteti i Historisë dhe i Filologjisë, Fakulteti i Shkencave të Natyrës, Fakulteti i Shkencave Sociale, Fakulteti i Drejtësisë, Fakulteti i Ekonomisë dhe Fakulteti i Gjuhëve të Huaja).

DEKLARATA

Më tej pedagogët kanë hartuar një deklaratë prej 5 pikash drejtuar kryeministrit Edi Rama dhe ministres së Arsimit, të Sportit dhe të Rinisë, Besa Shahini. "Me përgjegjësinë më të lartë për të ofruar mësimdhënie dhe kërkim shkencor të nivelit më të mirë për studentët tanë, me detyrën për të ruajtur dhe për të forcuar rolin e universitetit publik në Shqipëri, nxjerrim këtë deklaratë", - theksojnë pedagogët. Njëpër një kësaj shkresë, ata rikonfirmuan mbështetjen e studentëve për kërkesat e tyre, si dhe dolën kundër ligjit "Për arsimin e lartë" 80/2015. "Kërkojmë shprehjen e vullnetit të qeverisë për fillimin e procesit legjislativ për hartimin e një ligji të ri për Arsimin e Lartë, në bashkëpunim me studentët, pedagogët dhe aktorë të tjerë të rëndësishëm, në një proces konsultimi të hapur dhe gjithëpërfshirës. Kërkojmë shfuqizimin e menjëhershëm të VKM-ve të datës 26 dhjetor 2018: Nr.777, Nr.781, Nr. 783, si dhe urdhrat po të datës 26 dhjetor: Nr.183; Nr.184; Nr.185, të cilat bien në kundërshtim me autonominë universitare dhe lirinë akademike", - theksohet në deklaratë. Në këtë të fundit nënvizohet se stafet



Mbledhja e pedagogëve të UT-së



Edi Rama: "Prioritet arsimit profesional"

Kryeministri: Do të shkurtohen kuotat e pranimit në universitete

Kuotat në universitete do të reduktohen në mënyrë të ndjeshme, duke i hapur kështu rrugën arsimit profesional. Kjo deklaratë është bërë ditën e djeshme nga kryeministri i vendit, Edi Rama gjatë vizitës në një sipërmarrje të riparimit të profileve mekanike, e cila më parë ka qenë një oficinë e vjetër riparimesh. "I ka humbur dashuria për punën se duan të gjithë mastera shkencorë, i duan edhe pa lekë. E pse të vijnë të prishin duart



me punë. Në arsimin profesional kemi bërë hapa jo

shumë të mëdhenj, por të rëndësishëm. Do shkurtojmë në mënyrë të ndjeshme kuotat për hyrjen në universitete. Do hapim më shumë shkolla profesionale në mënyrë që të kemi krah të kualifikuar punë në prodhim", - theksoi Rama. Ky i fundit, ashtu si ka deklaruar më parë, ka kundërshtuar edhe dje uljen e tarifave për ciklin e dytë të studimeve master, të cilat do të përgjyeshmohen vetëm për studentët e ekscelencës me mesatare mbi 9.

akademike të UT-së kërkojnë edhe rritjen e buxhetit për arsimin e lartë publik si dhe ndalimin e menjëhershëm të fushatës denigruese ndaj pedagogëve dhe miratimin e statusit të pedagogut. "Presim përgjigje dhe masa

konkrete brenda datës 1 shkurt 2019 për pikat e mësipërme. Nëse kjo nuk ndodh, atëherë do t'i drejtohem të gjithë trupës akademike të universiteteve publike në nivel kombëtar, për grevë të përgjithshme. Ftojme të gjitha universite-

tet e tjera publike të shprehjen dhe të koordinojnë qëndrimet për sa më sipër", - paralajmërojnë pedagogët e Universitetit të Tiranës. "Takim historik i pedagogëve të UT, të gjithë bashkë për hedhjen poshtë të ligjit të arsimit të lartë,

mbështetjen e kërkesave të studentëve dhe garantimin me ligj të statusit të pedagogut! Kurrë më parë në këto 28 vjet demokraci, nuk ka ndodhur që pedagogët e fakulteteve të ndryshme të thejnë frikën nga pushteti dhe të organizohen për të kërkuar të drejtat e tyre në emër të një arsimit më cilësor dhe mbi të gjitha të lirë nga ndërhyrjet e politikës", - nënvizon pedagogia e Gazetarisë, Jonila Godole.

BOJKOTI

Në një kohë që një pjesë e studentëve, pjesa tjetër vijon bojkotin e mësimit. Përkatesisht studentët e Filologjikut, Gjuhëve të Huaja, Juridikut, Shkencave Sociale, e Shkencave të Natyrës. Studentët shprehën të vendosur për pezullimin e mësimit deri në plotësimin e 8 kërkesave të parashtruara qeverisë si dhe rrëzimin e ligjit për arsimin e lartë. Ndërkohë, rektori i Universitetit të Tiranës, Mynyr Koni zhvilloi dje një takim me dekanin e Juridikut, Artan Hoxha dhe me studentët e këtij fakulteti. Koni ka thënë se do të veprojë sipas kompetencave të tij dhe në një moment të dytë do të ketë një deklaratë.

1

SHKURT AFATI

"Presim përgjigje dhe masa konkrete brenda datës 1 shkurt 2019 për pikat e mësipërme. Nëse kjo nuk ndodh, atëherë do t'i drejtohem të gjithë trupës akademike të universiteteve publike në nivel kombëtar, për grevë të përgjithshme. Ftojme të gjitha universitetet e tjera publike të shprehjen dhe të koordinojnë qëndrimet për sa më sipër", - paralajmërojnë pedagogët e Universitetit të Tiranës.

5

KËRKESAT E PEDAGOGËVE

Më tej pedagogët kanë hartuar një deklaratë prej 5 pikash drejtuar kryeministrit Edi Rama dhe ministres së Arsimit, të Sportit dhe të Rinisë, Besa Shahini. Njëpër një kësaj shkresë, ata rikonfirmuan mbështetjen e studentëve për kërkesat e tyre, si dhe dolën kundër ligjit "Për arsimin e lartë" 80/2015 si dhe shfuqizimin e menjëhershëm të VKM-ve të datës 26 dhjetor 2018.

"Nuk ka kompetenca për të vendosur çmimet"

Vendimi i USSH/ Ministria e Shëndetësisë çon në gjykatë Urdhrin e Stomatologut

Pas publikimit të doku- mentit për vendosjen e çmimeve dysheme dyfish më të larta se çmimet aktuale nga Urdhri i Stomatologut, Ministria e Shëndetësisë ka çuar në gjykatë vendimin. Sipas ministrisë, USSH ka tejkualuar kompetencat dhe nuk do të ketë rritje tarifash për shërbimet dentare. "Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale çon në gjykatë vendimin e Urdhrit të Stomatologut. Pas kundërshtisë në votimin për vendosjen e tarifave për shërbimet dentare, Ministria e Shëndetësisë ka ndërmarrë një tjetër hap për të bllokuar vendimin e Ur-

DEKLARATA

Pas kundërshtisë në votimin për vendosjen e tarifave për shërbimet dentare, Ministria e Shëndetësisë ka ndërmarrë një tjetër hap për të bllokuar vendimin e Urdhrit të Stomatologut për rritjen e tarifave: Dërgimin në gjykatë të këtij vendimi, me argumentin se Urdhri i Stomatologut ka tejkualuar kompetencat. Sipas ministrisë, nuk do të ketë rritje tarifash, sepse vendimi i Urdhrit të Stomatologëve është i paaplikueshëm", -thekson në deklaratën e saj për mediat, Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale.

dhrorit të Stomatologut për rritjen e tarifave: Dërgimin në gjykatë të këtij vendimi, me argumentin se Urdhri i Stomatologut ka tejkualuar

kompetencat. Sipas ministrisë, nuk do të ketë rritje tarifash, sepse vendimi i Urdhrit të Stomatologëve është i paaplikueshëm", -thek-

son në deklaratën e saj për mediat, Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale. **REAGIMI NGA USSH**

Nëpërmjet një deklaratë në faqen zyrtare, Urdhri i Stomatologut bën me dije se Ministria e Shëndetësisë nuk do të implikohet në vetëqeverisjen profesionale të dentistrisë. "Në votimin e Këshillit Kombëtar pas votimit të zakonshëm si për të gjithë vendimet e tjera, presidenti kërkoi vendim nominal dhe kërkoi në mënyrë paqësore të mos implikohet në votim përfaqësuesit e Ministrisë së Shëndetësisë në votimin për për-



caktimin e çmimeve referuese dysheme në dentistri. Përfaqësuesja e Ministrisë së Shëndetësisë znj. Antoneta Njehrrrena ishte kundër këtij vendimi. Presidenti i USSH u shpreh se nuk e implikojmë Ministrinë e Shën-

detësisë në vetëqeverisjen profesionale të dentistrisë. E pamë të domosdoshme këtë sqarim për të kthjelluar mendimin e opinionit publik dhe atij dentar", -bën me dije Urdhri i Stomatologut.

Kreu i AKSHI: Planifikojmë që gjatë 2019-ës të shtojmë edhe 100 shërbime të reja

"e-Albania", 33 dokumente do të ofrohen me vlerë të plotë ligjore me vulë elektronike

Karçanaj: U kemi kursyer qytetarëve 70 vite pritje në radhë

Voltiza Duro

Tashmë nëpërmjet portalit "e-Albania" do të ofrohen 33 dokumente me vlerë të plotë ligjore falë vulës elektronike. Kjo, në sajë të marrëveshjes së bashkëpunimit nënshkruar dhe mes Agjencisë Kombëtare të Shqipërisë së Informacionit (AKSHI) dhe Postës Shqiptare, çka synon koordinimin e ofrimit të shërbimeve elektronike të portalit "e-Albania" ndaj qytetarëve dhe bizneseve në çdo zyrë postare të territorit të Republikës së Shqipërisë. Marrëveshja u nënshkrua në ambientet e zyrave qendrore të Postës Shqiptare nga kreu i Agjencisë, Mirinda Karçanaj dhe administratori i Postës, Laert Duraj. Më anë të saj, punonjësit e Postës do të mund të gjenerojnë përmes "e-Albania" dokumente me vulë elektronike. "Jo më kot krenohemi me jetësimin e këtij objekti, pasi u kemi kursyer rreth 80 milionë lekë të reja xhëpave të qytetarëve përmes ofrimit pa pagesë të certifikatave të gjendjes civile, si dhe iu kemi eliminuar atyre 70 vite kohë pritjeje në radhë në sportelet e administratës për nxjerrjen e këtyre dokumenteve. Marrëveshja e sotme sjell një risi në ofrimin e shërbimeve, pasi u krijon mundësinë qytetarëve dhe bizneseve të aplikojnë për shërbimet e portalit "e-Albania" nga çdo sportel i Postës Shqiptare në të gjithë territorin e vendit", u shpreh Karçanaj. Deri më tani numërohen mbi 3 milionë gjenerime në 15 muaj, nga të cilat më shumë se gjysma janë gjeneruar nga 7,300 punonjës të administratës publike, që kanë akses në portalin "e-Albania". Ndërkohë, Karçanaj bëri me dije se po punohet për shtimin e 100 shërbimeve të reja elek-



Gjatë nënshkrimit të marrëveshjes mes AKSHI-t dhe Postës Shqiptare

80

MILIONË TË KURSËRERA

"U kemi kursyer rreth 80 milionë lekë të reja xhëpave të qytetarëve përmes ofrimit pa pagesë të certifikatave të gjendjes civile, si dhe iu kemi eliminuar atyre 70 vite kohë pritjeje në radhë në sportelet e administratës për nxjerrjen e këtyre dokumenteve. Marrëveshja e sotme sjell një risi, pasi u krijon mundësinë qytetarëve dhe bizneseve të aplikojnë për shërbimet e portalit "e-Albania" nga çdo sportel i Postës Shqiptare në të gjithë territorin e vendit", u shpreh Karçanaj.

tronike gjatë vitit 2019. Kreu i AKSHI-t theksoi se prej 591 shërbimeve elektronike aktuale, funksionale në portalin "e-Albania", 122 prej tyre ofrojnë mundësinë e gjenerimit me vlerë të plotë ligjore, falë vulës apo nënshkrimit elektronik. Sakaq, Duraj tha se me firmosjen e

kësaj marrëveshjeje, sportelet e Postës do të transformohen në "One Stop Shop", duke iu mundësuar qytetarëve dhe bizneseve lehtësi dhe komoditet në përfitim të shërbimeve. "Risi për ne është tashmë fakti se te Posta Shqiptare, veç individit, mund t'i shërbejmë edhe bi-

znesit. Përmes Postës, biznese mund të kryejnë një sërë procedurash, duke kursyer kohë, si dhe duke paguar tarifa shumë të ulëta", u shpreh Duraj, duke premtuar gjithashtu tarifa modeste për individët.

SHËRBIMET

Çdo muaj portali "e-Alba-

SHËRBIMET MË TË PËRDORURA NË "E-ALBANIA":

- Certifikatat e gjendjes civile, me më tepër se 100,000 gjenerime çdo muaj.
- 9 vërtetimet tatimore si vërtetimi i xhiros së subjektit, vërtetimi për pagim detyrimesh, vërtetime të kontributeve të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore me mbi 50,000 përdorime në muaj.
- Dokumente të tjera të biznesit si ekstraktet apo certifikata e regjistrimit me rreth 10,000 përdorime në muaj.
- Shërbimet e aplikimit dhe gjenerimit të kartës së shëndetit, shërbimet konsullore 'online' dedikuar shqiptarëve jashtë vendit, depozitimi i bilancit vjetor në Qendrën Kombëtare të Biznesit, aplikimi për leje ndërtimi, pagesat e kundërvajtjeve rrugore, faturave të energjisë elektrike apo ujit etj.

nia" numëron mbi 1 milion vizita dhe mbi 400,000 përdorime të shërbimeve të tij elektronike, çka dëshmon se qytetarët dhe bizneset shqiptarë e shohin atë si kanal in kryesor të marrjes së shërbimeve publike. Ndër shërbimet më të përdorura renditen: certifikatat e gjendjes civile, me më tepër se 100,000 gjenerime çdo muaj, si dhe 9 vërtetimet tatimore si vërtetimi i xhiros së subjektit, vërtetimi për pagim detyrimesh, vërtetime të kontributeve të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore me

mbi 50,000 përdorime në muaj. Gjithashtu, qytetarët e përdorin portalin edhe për dokumente të tjera të biznesit si ekstraktet apo certifikata e regjistrimit me rreth 10,000 përdorime në muaj si dhe shërbimet e aplikimit dhe gjenerimit të kartës së shëndetit, shërbimet konsullore 'online' dedikuar shqiptarëve jashtë vendit, depozitimi i bilancit vjetor në Qendrën Kombëtare të Biznesit, aplikimi për leje ndërtimi, pagesat e kundërvajtjeve rrugore, faturave të energjisë elektrike apo ujit etj.

Autoriteti i Konkurrencës bën të ditur se ka marrë dënimin në lidhje me njoftimin e bërë publik nga Asambleja Kombëtare e Urdhrit të Stomatologut për përcaktimin e listës së çmimeve dysheme për shërbimet në klinikat dentare miratuar nga Asambleja Kombëtare dhe Këshilli Kombëtar. Sipas listës së publikuar, Urdhri i Stomatologut ka vendosur çmime dysheme për një kategori të caktuar shërbimesh dentare për: Terapinë, Ortopedinë, Kirurgjinë dhe Ortodon-



Konkurrenca nis vlerësimin për dyfishimin e çmimeve dysheme për shërbimet dentare

inë. Autoriteti i Konkurrencës, i cili ka si mision mbrojtjen e konkurrencës së lirë dhe efektive në treg, në bazë të nenit 69 të ligjit nr. 9121/2003 "Për mbrojtjen e Konkurrencës", i ndryshuar vlerëson shkallën e kufizimit ose të pengimit të konkurrencës të çdo projekt-akti normativ që, në mënyrë të veçantë, ka të bëjë me: a) kufizimet sasiore

për hyrjen në treg dhe tregtimin; b) vendosjen e të drejtave ekskluzive ose të të drejtave të veçanta, në zona të caktuara, për ndërmarrje ose për produkte të caktuara; c) imponimin e praktikave të njëjta në çmime dhe kushtet e shitjes. Prej fillimit të 2019-s, klinikat dentare në vend janë të detyruara që të bazohen në listën e re me çmimet dys-

heme për shërbimet bazë që ofrojnë, të caktuar në një shkresë të Urdhrit të Stomatologëve. Për një mbushje dhëmbi të gradës së dytë, përpara 1 janarit, pacientët në klinikën e tij duhet të paguanin 2,000 lekë, ndërsa tani me çmimin dysheme që ka vendosur Urdhri i Stomatologut, pacientët duhet të pagujnë 4,000 lekë, ose dyfish. Rritje ka pasur edhe

për shërbimet e tjera dentare. Pjesa më e madhe e klinikave në vend për vizitat e pacientëve (ekzaminim me sy) i kanë falas, por prej 1 janarit për vizitat çmimi dysheme është 500 lekë. Për mbushjet e gradës së tretë, çmimi ishte 3,000 lekë, ndërsa me referencën e re çmimi bëhet 5,000 lekë (2,000 lekë më shumë, shtrenjtim 67%). Çmimi për pastrimin e gurëzave dhe të cipave bëhet 3,000 lekë, nga 1,500 lekë, sa dyfishi. Heqja e dhëmbëve bëhet 1,000 lekë nga 500 që ishte.

Ndryshimet e ortakëve do regjistrohen në Qendrën Kombëtare të Biznesit

Drafti, vonesat e deklarimit për ortakëritë, gjoba 100 mijë lekë

Ja çfarë ndryshon në ligjin "Për regjistrimin e biznesit"

Bizneset që nuk do të deklarohen në kohë ndryshimet në strukturën e ortakërisë, brenda 30 ditëve, do të ndëshkohen me masa administrative, që arrijnë deri në 100 mijë lekë. Një ndryshim në ligjin "Për regjistrimin e biznesit" synon të rregullojë pikërisht këtë hallkë. "Aplikimi për ndryshimin e ortakut dhe strukturës së ortakërisë të personit juridik bëhet brenda 30 ditëve nga data e ndryshimit faktik të ortakut dhe strukturës së ortakërisë, me përjashtim të rasteve të parashikuara nga ligji", thuhet në draft-ligjin e nxjerrë tashmë për konsultim. Në rastet kur nuk respektohet ky afat, ndryshimet ligjore parashikojnë edhe masa administrative si gjoja. Konkretisht, moskryerja e detyrimit për regjistrimin e ndryshimit të ortakut dhe/ose strukturës së ortakërisë të personit juridik, brenda 30 ditëve nga data e ndryshimit faktik të ortakut dhe/ose strukturës së ortakërisë, me përjashtim të rasteve të parashikuara nga ligji, përbën kundërvajtje administrative dhe dënohet me gjobë 100 000 lekë. Për shoqëritë aksionare, mosplotësimi i detyrimit të përcaktuar në pikën 4, të nenit 43, të këtij ligji, përbën kundërvajtje administrative dhe dënohet me gjobë 100 000 lekë. Një tjetër ndryshim lidhet me personat që mund të bëjnë aplikimin fillestar për regjistrimin. Kështu, në nenin 26 pika 3 bëhet një ndryshim, ku nënvizohet se "aplikimi për regjistrimin fillestar të shoqërive tregtare bëhet bashkërisht nga të gjithë themeluesit ose nga administratori i shoqërisë, ose nga çdo person i autorizuar prej tyre. Aplikimi për regjistrimin e tjera bëhet nga personat përgjegjës për përfaqësimin e shoqërisë në marrëdhënie me të tretët ose çdo person i autorizuar prej tyre. Aplikimi për regjistrimin e veprimeve juridike, që lidhen pjesëmarrjet, kuotat apo aksionet, mund të kryhen gjithashtu edhe nga anëtarët, ortakët apo aksionerët, të cil-



it këto i përkasin".
KONSULTIMI I PROJEKTLIGJIT
Ndryshimet në ligjin "Për regjistrimin e biznesit" janë nxjerrë për konsultim në një paketë bashkë me ligjin

"Për procedurat tatimore" si dhe atë "Për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit e terrorizmit". Një tjetër ndryshim lidhet me personat që mund të bëjnë aplikimin fillestar për

regjistrimin. "Aplikimi për regjistrimin fillestar të shoqërive tregtare bëhet bashkërisht nga të gjithë themeluesit ose nga administratori i shoqërisë, ose nga çdo person i autorizuar prej tyre.

Transaksionet me biznese me status pasiv gjobiten

Bizneset e rregullta që kryejnë transaksione me subjekte në status pasiv do të gjobiten. Ligji për procedurat ka hyrë në fuqi dhe tatimet kërkojnë që të bëhet kujdes në këtë drejtim. Ndërkaq, në ligj janë bërë një sërë ndryshimesh të tjera, të cilat vendosin kufizime për hapjen e nipteve për personat fizikë si dhe detyrojnë subjektet të pagujnë detyrimet përpara se të kalojnë në statusin pasiv. Aktualisht pritet që ligji të kompletet me aktet nënligjore për zbatimin më efikas dhe synohet që me këto ndryshime të minimizohet evazioni fiskal dhe të zgjerohet baza e tatimpaguesve.

Aplikimi për regjistrimin e tjera bëhet nga personat përgjegjës për përfaqësimin e shoqërisë në marrëdhënie me të tretët ose çdo person i autorizuar prej tyre. Aplikimi për regjistrimin e veprim-

meve juridike, që lidhen pjesëmarrjet, kuotat apo aksionet, mund të kryhen, gjithashtu dhe nga anëtarët, ortakët apo aksionerët, të cilët i projektligjit.


Bizneset: Vë në rrezik ricikluesit dhe prodhuesit e materialeve të ndërtimit

Prodhuesit, kundër taksës mbi lëndët e para të plastikës

Vendosja e një takse mbi lëndët e para të plastikës ka vënë në alarm prodhuesit. Ky ndryshim i parashikuar në paketën fiskale të vitit 2019, që takson me 25 lekë kg për prodhimin vendës dhe 35 lekë kg për të importuarat për të gjitha produktet që përfshihen në Kodin 39 të NKM, si dhe taksat e granulatit të importuarit në vend të produkteve të plastikës, që hyri në fuqi në janar të këtij viti, prodhuesit shqiptarë vihen përballë një risku të madh në aspektin

shqetësime e shprehura dhe nga problematikat që kanë sjellë ndryshimet e fundit të paketës fiskale 2019, në ligjin nr. 9975, datë 28.07.2008 "Për Taksat Kombëtare", të ndryshuar dhe me konkretisht për taksat e materialeve plastike dhe e ambalazheve plastike të importuara në Kodin 39 të NKM, si dhe taksat e granulatit të importuarit në vend të produkteve të plastikës, që hyri në fuqi në janar të këtij viti, prodhuesit shqiptarë vihen përballë një risku të madh në aspektin

ekonomiko-financiarë të subjekteve të tyre duke çuar deri në mbyllje të aktiviteteve të tyre prodhuese. Bashkimi i Prodhuesve Shqiptarë pas tryezave teknike të zhvilluara me disa nga anëtarët në lidhje me këtë çështje dhe pasi ka analizuar situatën dhe efektet ekonomike-financiare dhe sociale që ka shkakuar ky ndryshim i ligjit të prodhuesit vendës zhvilloi sot një tryezë diskutimi në të cilën morën pjesë subjekte nga fusha të ndryshme të industrisë së prodhimit, si prodhues të ambalazheve



plastike, prodhues materialeve ndërtimi, bojëra, polisterol, prodhues tuba elektrike, kuti elektrike, aksessore elektrike, prodhues të garnicioneve për dyer dhe dritare, prodhim alumini dhe plastikës hekurit dhe nën-produkteve tyre, prodhues të çizmave dhe sandale plastike, prodhues tubash etj., si dhe përfaqësues nga Ministria e Shtetit për Mbrojtjen e Sipërmarrjes.

LEGALIZIMET LISTA ME PËRFITUESIT

Procedura për marrjen e certifikatës së pronësisë ndiqet nga 'Agjencia'

ALUIZNI: 500 personat që kanë gati lejet e legalizimit

Publikohet lista me përfituesit në Tiranë

ALUIZNI publikon listën me 500 personat që kanë gati lejet e legalizimit në Tiranë. Pronarët që kanë gati lejet janë në 11 njësitë e kryeqytetit dhe në zonat përreth. Përfituesit duhet të tërheqin lejet e legalizimit dhe më pas presin që Agjencia e Legalizimeve të ndjekë procedurën për pajisjen e tyre me certifikatën e pronësisë. Procedurat për marrjen e tapisë janë ndjekur nga ALUIZNI, i cili dorëzon dosjen e plotë në Hipotekë, por përfituesit duhet të shkojnë në Zyrën e Regjistrimit të Pasurive të Aplikojnë për tapinë. Pas

ndryshimeve të fundit ligjore, qytetari do të marrë një kopje për të vërtetuar mbarrimin e procesin të legalizimit, por e gjithë procedura vijuese për regjistrimin në Zyrën e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme do të bëhet nga 'Agjencia'. Ndërkohë që sipërfaqja e

parcelës për të cilën miratohet kalimi i së drejtës së pronësisë nuk mund të jetë më e madhe se trefishi i sipërfaqes së bazës së ndërtimit dhe për ndërtimet pa leje me funksion banimi jo më shumë se 500 m². Sipërfaqet mbi masat e përcaktuara në këtë pikë, të cilat, për

shkak të përmasave ose konfiguracionit nuk mund të shfrytëzohen më vete për ndërtim, i shiten poseduesit të ndërtimit pa leje sipas vlerës së pronës, të miratuar me vendim të Këshillit të Ministrave, vetëm nëse ka shprehur më parë vullnetin, nëpërmjet

një kërkesë me shkrim. Ndërsa në rastin kur ndërtimi pa leje disponohet nga më shumë se një person fizik ose juridik, regjistrimi i pjesëve takuese mbi pasuritë (parcelë dhe objekt) kryhet në pjesë të pandara, ideale, sipas numrit të subjekteve;

në pjesë takuese të ndara, sipas marrëveshjes së nënshkruar ndërmjet subjekteve lirisht dhe të depozituar brenda afatit të vetëdeklarimit. Subjektet mund të përcaktojnë përveç pjesës takuese edhe pjesët fizike respektive, nëse ndërmjet tyre përpulthet vullneti.

PERSONAT QË KANË GATI LEJET E LEGALIZIMIT NË TIRANË

XHEMAL ALI HIDA
FATOS HALIM LILA
AMIR ALI PEPOSHI
SHYQYRI BESHIR
MARKU
ISLAM MYSLIM
HAKCANI
PASHK UKE ALIA
ENVER STAF PERHALI
ALBERT QANI KAJA
ENVER KAMBER
SALLAHI
SKENRDINAND QANI
KAJA
IBRAHIM RAMAZAN
LIKZELIA
KADIFE ALI HAKA
XHEMAL SHERIF TROCI
IDAET NURI SHUKULLI
DED LULASH NIMANI
ISMAIL RIZA SHEHI
RUSHIT FADIL ELEZI
NAIM ALI SINA
GJELOSH KOKER
PREBIBAJ
REFIK BEQIR HOXHA
RAMIZ XHEMAL
LUSHNJA
BISLIM AZEM AJDINI
DRITAN FIQIRI BUSHI
ISTREF SELAM DOMI
ISMET MUHARREM
ZISKO
XHAFER AHMET
MULGECI
AMIR SINAN SPAHIU
KOL GJERGJ QUNI
PERPARIM SHERIF
BULKU
ZYHDI ZENEL SIPRI

NAIM XHEMAL RRASA
XHAVIT RIFAT SUFAJ
PJETER MHILL ALIJA
BEGLIE RIZA BATALI
RASIM IBRAHIM
MEHIDRI
REXHEP HASAN SHEHU
LEKE MARTIN LEPEJA
RAMAZAN XHEVDET
BOSHKU
FERIT XHEMAL ZHUZHI
HASHIM MAN
DRAGJOSHI
TEUFIK RIZA COLLAKU
ARJAN GJOKE RRAHI
SELMAN RIZA TANUSHI
NIKO MYSLIM VILA
IBRAHIM MURAT
KUNXHIU
RUTE KOL KACI
MURAT AVDI FIDA
DRITA JONUZ RAMA
ENVER ISLAM MISKU
ROMEO DANIELA HODO
ILIR SHEFQET SHEHAJ
GJON LLESH DOCI
PASHK LUSH MARKU
ALI FAIK RAMA
ENGJELL AVNI MATA
PREKE PALI PERPELAJ
KADRI FUAT ALUSHI
ZAIM HYSEN VESELI
FERIT SHAQIR BOSHKU
ILMI MURAT BOSHKU
ALLAMAN IBRAHIM
DOKU
PJETER GJOK DEMAJ
LUAN ABAZ SHEHU
SHKELQIM IBRAHIM
GJOKA

ARJAN QAMIL SEJDINI
HAMZA SABRI LILA
MIMOZA ENVER
ZYBERAJ
RUSTEM SELMAN
RRUSHI
FATMIR SALI PLAKU
HALIM SHABAN BRIJA
ALBAN XHAFER BALLA
FATMIR MARK SUSAJ
LULEZIME NEZIR DURA
MARK ZEF VUKZA
ARBEN HAXHI SULAJ
PERPARIM VEHAJ
XHEKA
MOJSI OSMAN TURJAN
ILIR MEHDI HYSA
PETRIT RAMADAN
SHERIFI
XHEVDET RAMADAN
CANE
BESIM RUSTEM
MANSAKU
KUJTIM MULI BASHA
GJOVALIN PJETER
QOKAJ
ASTRIT HAMDİ PUCI
FAIK DEMIR BLUSHI
YLLI ENVER PRAPA
SERVETE MUHAMET
BENGO
KLODIAN HYSNI
TAKACI
KRISTAQ BEQIR VOGLI
ISMAIL GANI LALA
ALTIN BAJRAM PULA
NAZMI HAMDİ SUKİTHI
FAIK DEMIR BLUSHI
YLLI ENVER PRAPA
SERVETE MUHAMET

BENGO
ALI SHABAN MADANI
SHYQYRI OSMAN DEMA
ANESTI HAKIL ZGURO
ESAT RAHMAN KURTEJ
ALI BIB FIRI
MURAT XHELADIN
BEQIRI
GEZIM SUL DEMA
BESIM LIMON GACI
LIRETE HYSEN KADA
MARK ZEF VUKZA
MURATI
DURIM HALIM
PERGJEGJI
VERA BRAHIM DEMUSHI
XHEVAHİR DED
MARASHI
RAMAZAN HAMIT
MATRISI
PERPARIM FADIL
XHAFERI
HYSNI JONUS XHAFI
ANTON NDUE BRACI
KASEM OSMAN UZUNI
XHAFERR QAZIM
FILOLLI
FEMI AVDI HYSENAJ
SELADIN QAZIM
IMERAJ
GJELOSH PREL ALIAJ
LAVDIE HAMIT DAMZI
MARASH MHILL
IMERAJ
NAPOLON RESUL
ABAZAJ
AGRON MIRASH
BOSETA
SHYQYRI HAMDİ VATA
NAZMI SHABAN HYSA

MUHARREM TEME
BRAHIMI
MEXHIT MUHARREM
LIPO
ASTRIT FAZLI BRATI
ARTAN GJON QOKAJ
ZYHDI FAIK HYSA
DORJAN SELMAN
BENGU
ZENEL FETAH IBRA
XHEMAL HAJREDIN
SHEHI
HAKIK HAKIK SHOUTI
PETRIT VELI NAZO
GJERGJ JAK DODA
ALBERT HASAN DUCKE
MARASH KOLE QOKAJ
VALIDE HAXHI RUCI
MARINGLEN IRFAN
METELLARI
SAFET MURAT
HOXHALLARI
QAZIM ZENEL ZELA
MALIQ LIVAN
KLOGJERI
GRAMOS ASLLAN
LLAPO
BILBIL MYFTAR
LLAPANJI
BESNIK AVDIL PACI
TODI PALE NDONI
VERIE CAUSH LLAPO
HAJREDIN BAJRAM
CAUSHAJ
ROZETA RAMADAN
SHKEMBI
BUJAR GANI ZENELI
PERPARIM REFAT ZANI
ARBEN NEZHDET
TEROLLI

HYSNI IDRIZ ISUFAJ
VASFI SHERIF GJONI
MIRJAM NUSRET ALI
ARSHI MALIQ BARDHI
ALI RAMIZ QINANI
ILIR SADIQ TUSHA
REFAT SELMAN ALLA
BAJRAM XHAVIT
KALECI
MESAR CAUSH
SINAMETA
IBRAHIM ABDI HOXHA
ILMI JASHAR HOXHA
SHEFKI SEXHADIN
SHKEMBI
BASHKIM AZIS NDREKA
VANGJEL DILAVER
NUHO
FILE ADEM CANI
LUTFI XHEMAL
DRISHTI
ADRIATIK RUFAT CENAJ
MYRVETE TAHIR MERA
JANI ISMAIL ZHUZHI
AVNI XHAFER
JANGULLI
BASHKIM QAZIM MUJA
XHEMALI MEXHIT
KOLTRAKA
QEMAL SHIQUERUKA
NAZIF HIME KADRUI
ELHAM HAQIF ZHUZHI
SAMI DALI SULA
PETRIT NEXHIP LIKO
KLEMENT SINAN
BRAHMANI
FATOS BASHKIM MIRA
LEONORA BAJZIT
JETMIR MEXHIT YZO
SHEFKI JONUZ TATA

ALUSH ILJAS ZIRA	XHAMBAZI	MURATI	ALEKSANDER ZEF	EDMOND ABDI SULA	SINAN SEIT KAZANI
SHEFIK ULVI CAUSHI	SHEFQET SOKOL	SEFEDIN FEHIM MERO	MURRI	JEMIN ASLLAN LIMANI	LATIF RIZVAN ABRASHI
NEXHMI HAMZI HYSA	LUSHAJ	ERVIN ABAZ DUSHKU	LIMAN LIMAN TOSKU	BYLBYL PAL MEMA	AHMET SABRI POPSHINI
RAMIZ GAFUR HASA	AGIM NIJAS	ANASTAS XHEMIL ZACE	SHYQYRI MAHMUT LICA	FATMIR IZET QERIMI	ARBEN MYSLYM
ENVER SEFEDIN DAUTI	BASHLLARI	VALTER SEFEDIN	LAZIM QAMIL KRUSA	PJETER ZEF VATAJ	DURISHTI
ASLLAN SULEJMAN	LUAN SKENDER	MERO	ESMA ALIM HAMZAJ	LIRI ZYBER BEKA	MUSA MEXHITKABILI
LOCA	XHAMBAZI	PETREF NEHAT TOPI	DED MHILL THANA	MINA NAIM SHTEMBARI	DALIP HYSEN RAMA
SHERIF HAXHI	MYFIT RAMADAN	LUAN EQVER ZYFERI	ISMAL HASAN	NURI VEPRON FERATI	FERIT AHMET
HAJDARI	LALAJ	LUAN EQVER ZYFERI	MANREKA	HAZIZ ABEDIN	NDREGJONI
SHEFQET XHEMAL	SHEFQET SOKOL	SAIMIR IDAJET KOBUZI	BEDRI XHAFAER VEIZI	XHAMBAZI	SEFEDIN QAMIL
ALIMADHI	LUSHAJ	ADMIRIM ZIJA	SABRI ISMAIL	FAHRI DILAVER RAMA	XHAMBAZI
NAZMI FASLI DURAKU	ASTRIT REXHEP	KORANCE	VISHKURTI	GJERGJ KOLE QAVEZA	PETRIT JONUZ MEMA
GENCI HAXHI PICI	LIKSALA	MUHAMET DAUT	FESTIM DYLEJMAN	FATMIR FAIK MATJANI	ILIR ASLLAN MUCEKU
SOKOL PETRIT ALIAJ	ZIHNI ALI MILA	HAJDARAJ	HOXHA	PELLUMB ZEF QOKAJ	FESTIM VASFI META
ARDJAN PETRIT ALIU	PETRIT SHYQYRI	RUKIJE CEN LAMA	BAHRI AHMET BEQIRAJ	AGRON DEMIR DEMIRI	DRITAN SKENDER
NAZMI MUHARREM	THOMARAJ	TURHAN SELAM CELA	PREND ZEF MEMAJ	HANKE YMER DOMI	ALLUSHI
KIKA	RROK LULASH UKA	KADRI NASIBI HOXHA	KLODIAN SKENDER	SHPETIM ABDULLA	ZAMIR ALI BARDHI
ZAIM VESEL GAZIDEDE	ASTRIT RAKIP OSMANI	SHKELZEN XHEMALI	TAHIRI	MURATI	HASAN ABDYL RECI
ZEQIR SULEJMAN	ARDJAN ENVER LOCA	SHUPLI	SAIMIR HIQMET	SHANIKE SALI HYSENI	KUJTIM NIKOLL
BARDHI	JANI RAMIS HAJDARI	ALBAN LAZAN	XHAMBAZI	ALI ASLLAN HALILI	GJONAJ
ILIR SALI ISMAILI	TON MARK PJETRI	KOLDASHI	RAMAZAN SELAMI	ILIR SHEFQET SHEHAJ	HAN IBRAHIM NDREKA
HASAN RAMADAN	GJELINE PJETER BUCI	FITIM HAMDI KATESHI	KARIMANI	VLADIMIR FIQIRI DAMZI	BLERAND HASIM
DOKA	DEDE NDUE MISHAJ	BUJAR DEMIR HAJDARI	AGRON HILMI SHERIFI	AGRON SHYQYRI BANI	HASANI
ROBERT AQIF BICI	KUJTIM MARK ALIA	ARTAN BELUL ISUFI	NDOKE SOKOL	KUJTIM DAUT BARDHI	ABRAHIM ISLAM
SURJA RUSHIT	TONIN DED NDOU	GAZMEND XHEMALI	KOLENDREU	REFIK DERSH BRUCI	PROZLLAMI
DERNOVA	MARK DED NDOU	SHUPLI	SHABAN SULEJMAN	HAMDI SELAMI	FITIM SHEFQET ISLAMI
FARI NEBI DRAGJOSHI	NEXHMIJE SADIK	SADIK DALIP LUMI	ALLUSHI	KARIMANI	MIFTAR XHEMAL TOTA
ISUF HALIT MULDAKAJ	ORUCI	REFAT ABDI BALLA	AGRON XHEVIT DULAJ	RUSTEM DYLEJMAN	SKENDER ISMAIL
ANDON JOSUF NIKA	ALBAN HYSNI HYSA	KLAUDIO KASTRIOT	RESHIT LIMAN SALA	HOXHA	MEHMETI
DALIP XHEP GJANA	FEHMI XHELADIN SUTI	HYSENBELLI	DILAVER BATO BASTRI	GJELOSH NDOKE SUSAJ	HASAN HAXHI AFMATAJ
BESNIK RIZVAN	ZEJDI ELEZ KOPSHTI	FEHMI KUJTIM GJANA	MISIR ISMAIL MAXHAKU	MUHARREM REXHEP	PREL MARK VUKSANI
KARANXHA	MARTIN PRELE DEDAJ	VENDIM DAUT HAJDARI	BASHKIM VELI ISAKU	GANI	ZEF MIRUSH PREKAJ
ENGJELL MUHEDIN	BEDRI ELEZ KOLA	SOKOL VAZIM COLLAKU	ZENEL BILAL LAMA	HAJDAR MALIQ HIDA	MEDI AGIM KACA
SHEHU	NIKO MYFIT TOPI	NAIMBESIM BILALI	BLERAN TOLE ARAPI	BESIM LIMAN SALA	HAKI BAJRAM GJUZI
DRITAN HYSNI KOCI	KUJTIM IBRAHIM CACA	SHPETIM SHEFQET	LAVDERIM XHEMAL	FANOL FERAT DUMANI	XHETAN NAZIF LUMI
FESTIM ALI ALLARAJ	SELIM SHEFQET GJANA	SAHITAJ	CENA	VEBI DERSH BRUCI	KUJTIM PAL MEMAJ
DELI PJETER SHEQERI	FAIK ISLAM ISLAMI	XHEVDET ALI MUCA	FERJAT SEFEDIN	SHQYQYRI HAJDAR	MARASH PAL PROGNI
KRISTIAN DEDE MULAJ	HANEME REFAT MECE	EDMOND CELNIK	DALLIU	BEKA	MAN OSMAN SHIMA
KOLE TONE SHKAMBI	ISLAM XHEFERR HOXHA	PRENJASI	RAHMAN DEM	FRAN MHILL	SHKELQIM GJOVALIN
NEZIR SELMAN	BUJAR TASIM MATA	ÇLIRIM BARI ADILAJ	BARDHOSHI	BUSHGJOKAJ	ARAPI
CANAMETI	KOL DED POPAJ	ALI HAXHI XHEPA	SULEJMAN XHELADIN	ILIR MUNIR UKA	LUMTURJE MEXHIT
DASHAMIR NUREDIN	SHEFKI ELMMAZ SULI	SELM MUSE RROGAMI	KOLECI	IRAKLI MUSTAFA HYKA	KABILI
SEJDINI	DRITA QERIM	JANI SAFET PASHO	FRAN SOKOL RAMAJ	KADRI BAJRAM GJUZI	XHETAN NAZIF LUMI
HAXHI GANI HALILAJ	MUHARREMI	SHPETIM FASLI CELIKU	MAHIR BAJRAM RAMA	JASHAR DALIP KACI	KUJTIM PAL MEMAJ
SADIK IBRAHIMI LOKA	GENCI JANI CIKO	LIRIJE SHERIF PERA	QEMAL JAKUP TARJA	XHEMAL HAJDAR	ABDULLA HYSEN
FATOS SADIK LOKA	HASAN BAJRAM BASHA	XHAVIT IBRAHIM	AJDIR ILJAS MUCA	KACOLLJA	KRASNIQI
ASTRIT NAZIF	TEZEZE MARK NIKOLLI	GJOSHI	SELMAN REMZI KODRA	GJURI RAMADAN POLICI	NAZMI DEMIR TOCI
ZEMBLAKU	RAHIME SHERIF	FATMIR VESEL LLENGA	ALBAN PETRIT BEKA	ZHUJE SHERIF NEZAJ	DRITAN LUSH HASVATA
PASHK JAKU CUNI YLLI	SHALCA	FATMIR VESEL LLENGA	DIN RRUSTEM ISMAILAJ	SULEJMAN HAMID BANI	PLUM NIKOLL
PASHK CUNI	RAMAZAN RAMADAN	LUFTIM SELAMI	UZIR AMZA HAMZAI	GEZIM HASHIM DELIU	DEDNDREAJ
KASTRIOT SELIM DODA	TERSHALLA	KORIMANI	KUJTIM ISUF KOKA	EDUARD GJIN GJONAJ	KLODIAN XHAVIT
ISLAM ILJAZ RUDAKU	OLSI RAPO KLEPKA	SULEJMAN BEQIR	SHABAN ISLAM SMALAJ	XHEVAT ISLAM ISMALAJ	KOTORI
KUJTIM NAZIF	ARDIAN QAMIL GJONI	BALLIU	SABRI BAJRAM LLUAKJ	HEKURAN SEFEDIN	ALFRED ABDULLA
ZEMBLAKU	AGIM HALIL BOCI	AHMET HASAN	NIMET EMIN QEMALI	MANCILA	MEMAJ
DED IBRAHIM STEAJ	TEFTA SYRI RAPO	SHKEMBI	RAM MEHMET	QAMIL MUHARREM	SKENDER DILAVER
FLAMUR KADRI CANI	LIMAN HAZIZ KOKA	PELLUMB RAMADAN	AHMETAJ	MANI	BALLA
SADIK LLAN PECA	ILIA ALI KOKA	OSHAFI	ZENEL ABEDIN	SHKELQIM HYSMET	BAJRAM QAZIM HYSA
FEJZO SULO LAMA	BUJAR SELAMI BREGU	KUJTIM DERSH MUSI	XHAMBAZI	KAZANI	ALFRED BAFJTAR
ARBEN REXHEP SHULI	FIDANE REXHEP DUKA	DYLBERE NUREDIN	REXHEP SADUSH LIÇI	SOKOL ZEF VATAJ	XHUTI
BASHKIM OSMAN	SAFET GURALI	SULA	PAJTIM REXHEP	DYLBER ZEJNI YMERI	HYSEN IBRAHIM SALKU
MEHMETAJ	HOXHALLARI	BUJAR MERSIN NEZIRI	HABIBASI	FATMIR HEBIP EBIP	HALIT RIZA NAZMI
LATIF SALI KAZANI	RAHIM RAMADAN ZILI	TEFIK SKENDER LIÇO	BEQIR QAMIL LIKA	NDUE MARK LLESHI	SHABAN MECI
BEKUR XHELAL MURJA	KRESHNIK HALIT	FADIL ALI LIKA	RAMADAN BESIM RAMA	AGIM SULEJMAN KRUIJA	ARTAN MALIQ SPAHO
HEKURAN IBRAHIM	KUKELI	DEMIR QAMIL KRUSA	BILAL HAMIT ÇUNI	LORETA KADRI BEGANI	KRASNIQI
SELISHTA	PASHE ISMAIL AGO	DRANE ZEF GJINI	PETRIT BAJRAM KECI	ARBEN ABDULLA MUCA	SHKELZEN ZABIT
ANDREA NEXHIP NANO	NIKOLIN FERIT ALLIU	ÇLIRIM NEXHIP HALILI	ASTRIT ABDI GJAPI	EMIN OSMAN KACANI	KOLA
ARBEN ZEF MARKU	KIN NDOC GJONPALI	HAJRULLA HAMIT	PETRIT OSMAN BEQIRI	LORETA KADRI BEGANI	
AGIM NIJAS	ISLAM MUSTAFA	MUÇA	GJON NIKOLL MALETAJ		
BASHILLARI	HALLVAXHIU	GANI DERSH MUSI	MEHDI SHEFQET		
LUAN SKENDER	SHAQIR SELMAN	ELIDON ABDI SULA	KARABRAHIMI		
		PREK LULASH GJOKLAJ			

BalkanWeb.com

AGJENCIA E LAJMEVE MË E KLIKUAR NË HAPËSIRËN SHQIPTARE.
LAJMET MË TË FUNDIT ME VIDEO DHE FOTO NGA VENDNGJARJA,
ANALIZA DHE TEMATIKA TË NDRYSHME, GJITHÇKA ME NJË KLIKIM.



MERRNI NE KOHE REALE LAJMET E FUNDIT NE APARATIN TUAJ
CELULAR SMARTPHONE OSE TABLET



INSTALONI APLIKACIONIN E BALKANWEB NE MOBILE DHE TABLET
KERKONI NE APPLE STORE DHE GOOGLE PLAY OSE DUKE SKANUAR
QR CODE APPLE DHE ANDROID

BalkanWeb.com
BW

FALAS





BLUE TOOTH

Thashetheme
MADE IN ALBANIA

Nr. 645

SUPLEMENTI I PERJAVSHEM GAZETA SHQIPTARE

Redaktore: Pamela Aliaj - Art Designer: Nevila Samarzhi

E shtunë 26 Janar 2019

XHESIKA MUÇAJ

Vjen në stilin amerikan: Ëndrra ime u bë realitet



86.1.52

"Çdo prind të stimulojë fëmijën për të ecur përpara, dhe të ndjekë ëndrrat e tij"

**I HUTON TË
GJITHË ÇILJETA: JA
PSE VENDOS
TË LARGOHET
NGA EKRANI**



SHERR NË 'PARAJSE'?

ORIOLA dhe NOIZY prishin raportet, Varrosi do t'i pajtojë


Fansat çmendin me komente modelen. Dikur shumë të afërt, tani jo më, detajet që sjellin dyshimet e zënkës



• HABIT PREZANTUESJA SHQIPTARE: KAM FJETUR ME DY VIP-A! • NDRYSHON KOMPLET SONI MALAJ, S'DO TA NJIHNI ME PAMJEN E RE! • LUANA VJOLLCA DEL FRESK FARE! • RRËFEHET FLAKA KRELANI: PRISJA PRINCIN, POR MË ERDHI VETËM KALI! • S'KA SHPRESA PËR VAJZAT E 'INSTAGRAMIT', KËNGËTARI SHQIPTAR DO KËTË LLOJ VAJZE PER VETEN

Habit prezantuesja shqiptare: Kam fjetur me dy VIP-a!

Moderatorja e njohur, Arjola Shehu ka qenë e ftuara e radhës në emisionin "Pop Culture". Arjola këtë herë ka habitur të gjithë me deklaratat që bëri me Kelvi Kadilin. E pyetur nëse ka fjetur me ndonjë personazh të njohur shqiptar, moderatorja Shehu 'çudit' me përgjigjen. "Jo me një, por me dy personazhe të njohur shqiptarë", ka thënë ajo para kamerës teksa nuk ndalej së qeshuri. Vlen të ceket se Arjola ka qenë autore e emisionit "Kush vjen për drekë" dhe së shpejti vjen me projekt të ri televiziv. Kush të jenë vallë dy VIP-at?



Luana Vjollca del fresk fare! Nxjerr foto me pizhama në Rrugën e Kombit

Ditën e djeshme Luana Vjollca është ngritur që në mëngjes pa pikë grimi dhe me pizhame. Moderatorja dhe këngëtarja shqiptare ka postuar disa imazhe në 'Instagram' teksa shfaqet me pizhame. "Nga krevati në makinë, akoma me pizhama", është mbishkrimi që ia ka vënë njëres fotos e që në tjetrën shkruan: "Kartolina ime e dimrit : Pizhama, Borë, Makinë e palarë. Uuu edhe unë e veshur si një lopë". Moderatorja vazhdon të jetë e angazhuar në projekte muzikore pas përfundimit të emisionit të saj "Shiko kush luan". Përveç kësaj, ajo shpesh befason fansat e që së fundmi hapi edhe një biznes të ri me fustane. Kush është projekti i radhës?

Ndryshon komplet Soni Malaj, s'do ta njihni me pamjen e re!

Këngëtarja shqiptare, Soni Malaj është tejet e përfolur nga mediat rozë si për jetën private ashtu edhe atë profesionale. Së fundmi ka postuar një foto në llogarinë e saj personale 'Instagram', ku ka ndryshuar stilin e flokëve dhe tashmë duket shumë bukur dhe tërheqëse. Ajo ka prerë balluket dhe këtë ndryshim fansat e saj e kanë pritur shumë mirë pasi e kanë komplimentuar këngëtare për stilin e saj më të ri përmes komenteve pozitive. Këngëtarja është përfolur edhe për jetën e saj private, sidomos për lidhjen me biznesmenin nga Tirana, Kelvinin.



Rita Ora bashkëpunon me stilistin e njohur, nxjerr koleksionin e ri të çizmeve dhe këpucëve

Rita Ora, këngëtarja shqiptare me famë botërore, vazhdon të jetë një prej emrave më të njohur të muzikës britanike. Ajo është shumë aktive në promovimin e albumit të saj të fundit "Phoenix", të cilin e sollti për fansat në nëntor të vitit të kaluar. Pas koleksionit të veshjeve sportive që ajo ka lançuar në vitin 2016, 28-vjeçarja është gati edhe për një koleksion të ri. Këtë herë ajo po vjen me diçka më ndryshe. Ylli kosovar ka lançuar koleksionin e ri të mbatheve që përfshijnë, këpucë, çizme. Rita ka bashkëpunuar me emra të njohur si Giuseppe Zanotti për të sjellë një koleksion më ndryshe që do mbajë emrin GZxRitaOra. "Kush është gati të ecë në këpucët e mia? GZxRitaOra është këtu. Këpucë seksi, çizme dhe aksesori të mijsë të preferuar" ka shkruar Rita në 'Instagram'. Gjithashtu, Rita ka bërë të ditur se albumi është renditur në Top-5 albumet më të dëgjura nga një artistë në 2018 si dhe albumi i 6 më i dëgjuar nga një artistë në Angli.

E harroi shpejt Morenën! Ish-i dashuri i saj pozon në shtrat me tri femra

Sasha Sobhani së bashku me Morena Tarakun u përfolën muaj më parë se ishin në lidhje, e cila përfundoi në vetëm, pak javë. Morena dhe Sasha në fillim të lidhjes u shfaqën tejet të lumtur, madje bënë edhe emrat e njëri-tjetrit tatuazh. Ndërsa pas kësaj lidhjeje është Sasha ai që ka publikuar imazhe të ndryshme me femrat, por kjo e fundit është më se 'e nxehtë' ku duhet se po e provokon Morenën. Milarderi Sasha shfaqet nga dhoma e një hoteli luksoz me tri femra, të cilat janë shtrirë afër tij gjysmë të zhveshura, derisa ai duket me një laptop në duar teksa shkruan: Duke punuar. Sasha është afruar edhe me yje tjera shqiptare, duke tentuar ta bëjë xheloze ish të dashurën e tij. Tashmë i përket së shkuarës!



Nga lidhja në martesë? Arbenita vesh fustanin e nusërisë

Përej disa kohësh Fero dhe e dashura e tij, Arbenita kanë shfaqur publikisht dashurinë e tyre, shpeshherë duke dhënë edhe deklarata kontradiktore rreth kësaj lidhje. Edhe pse më parë u përfol shumë edhe për ndarje të mundshme të tyre, duket sikur shumë shpejt lidhja e tyre ka avancuar. Arbenita ka publikuar në Instastoryn e saj një video ku shfaqet me fustan të bardhë nusërie, teksa hedh pas saj buqetën me lule. "Nuse e ardhshme", shkruan modelja krahas postimit, duke i lënë të gjithë kuriozë për detaje të tjera rreth planeve të çiftit. Më vonë ajo ka postuar storie tjera ku tregon që fotoja ishte pjesë e pamjes së reklamës në të cilën është duke punuar si modele.



Arrin deri në Francë! Moderatorja shqiptare pjesë e revistës prestigjioze

Albana Osmanin e kemi parë të ketë një sukses të madh në shumë fusha: si moderatore, piktores dhe drejtuese e një shoqate bamirësie. Emri i saj është bërë shumë i njohur edhe jashtë trojeve shqiptare dhe e kemi parë shpesh të bëhet pjesë edhe e kopërtinave të revistave ndërkombëtare. Pak kohë më parë ajo u shfaq në një revistë gjermane dhe londineze, ku foli për të gjithë karrierën e saj dhe në veçanti për fondacionin "Ti je një luledielli". Së fundmi Albana është shfaqur edhe një revistë kulturore franceze, "Utopian Magazine". Për Albanën ka qenë një kënaqësi e veçantë të bëhet pjesë e kësaj reviste, sepse drejtohet nga djali i profesorit të saj të liceut. Duke qenë se Albana është e specializuar në fushën e arteve vizive këtë herë ajo është shfaqur në profilin e një artisteje. Një frymëzim për të tjerët apo jo?



Rrëfëhet Flaka Krelani: Prisja princin, por më erdhi vetëm kali!

A të e njohim si një nga këngëtares më eksplozive në skenë. Së fundmi, Flaka Krelani ka folur hapur për jetën e saj private, duke thënë se s'po mund ta gjejë personin e duhur. Ajo është një nga zërat më të dashur për publikun shqiptar, sidomos ata që pëlqejnë muzikën "rock". E ftuar në "Wake Up", këngëtarja, krahas projekteve që pritet të realizojë gjatë këtij viti, u ndal edhe në jetën personale. Flaka rrëfeu se ende nuk e ka gjetur princin e zemrës, duke treguar edhe fjalën e urtë që përdoret në Kosovë: "Është nisë princi me kalin, por mbërrin vetëm kali". Hall të madh ka deri sa ta gjejë, por e sigurtë që do të vijë në këmbë sipas gjasave!

Voilà



Rrëfëhet moderatorja e "Voila": Më ka prirë për mbarë "Pop Culture"

XHESIKA MUÇAJ vjen në stilin amerikan: Ëndrra ime u bë realitet


"Çdo prind të stimulojë fëmijën për të ecur përpara, dhe të ndjekë ëndrrat e tij"

Pamela Aliaj

Viti i ri ka sjellë nisjen e emisioneve të reja në mediat vizive. Fytyra të reja po i shtohen në çdo sezon të ri edhe Top Chanel, duke i dhënë kështu të rinjve një mundësi për t'u identifikuar e afirmuar me talentin e tyre. Një talent i tillë, fituese edhe e "Top Talent 1", është Xhesika Muçaj, e cila këtë sezon nis me emisionin e saj më të ri, "Voila". Në një intervistë ekskluzive për "Blue-tooth" të "Gazeta Shqiptare", Xhesika ose, siç preferon ajo të quhet, Xhesi, na rrëfen rrugëtimin e saj më të ri në ekran. Si lindi dëshira për të qenë pjesë e medias, përfshirja e saj në produksione të tjera si dhe pasionet e saj të pashprehura do të mund t'i mësoni në intervistën e mëposhtme.

Xhesika, për herë të parë në moderimin e një programi krejt tuajin rozë. Si lindi ideja për të qenë drejtuese e "Voila"?

Si fillim ju falënderoj për intervistën. Unë jam prezantuesja e emisionit "Voila", i cili do të transmetohet çdo të premte në kanalën e Youtube në Top Channel në orën 19:00. Emisioni ka një autore, dhe një redaksi me disa per-



sona që punojnë për të sjellë një emision me stil amerikan: showbiz dhe lifestyle. Unë kam nisur me "Pop Culture", i cili është program rozë dhe më pas me "Voila". Më ka prirë për mbarë "Pop Culture".

Pse zgjodhët pikërisht Top Chanel për të qenë pjesë e ekranit?

Unë jam një nga fituesit e edicionit të parë të "Top Talent". Më zgjodhën për të qenë





ijët dhe është një ndjesi shumë e bukur. Fëmijët janë të çiltër, dhe më pëlqen bota e tyre e brishtë.

Cilat janë surprizat e këtij formati?

Voice Kids është një format që promovon të gjithë fëmijët e talentuar në muzikë, dhe ka shumë të tillë në këtë edicion. Do ketë shumë surpriza, por që me mirë se sa unë i di Dojna Mema dhe autorët e "Voice Kids 3".

Kush do të ishte formati që do t'ju përshtatej më tepër përveçse "Voila"?

Ndihem shumë mirë tek "Voila". Kam disa projekte të tjera, por nuk dua t'i zbuloj. Më vjen shumë mirë që punoj në një media që përkrahin të rinjtë, dhe na ofrojnë mundësi për të ecur përpara.

Ka qenë gjithnjë në planet tuaja ekriani apo keni ndonjë ëndërr tjetër të parralizuar?

Unë kam dashur përherë ekranin. Por më ka shtyrë mami shumë që të konkurroja në "Top Talent". Dhe ka bërë shumë mirë, këtë duhet të bëjë çdo prind të stimulojë fëmijën për të ecur përpara, dhe të ndjekë ëndrrat e tij.

Së fundmi, mund të na flisni pak më tepër për "Voila" dhe e veçanta e këtij emisioni rozë? Pse pikërisht ky emër?

Voila do të ketë lajme nga personazhet publike, intervista të shkurtra, por që do të kenë pyetje pak provokuese. Emrin e ka propozuar autorja, dhe ka pyetur të gjithë stafin: "Si ju duket?" Secili nga ne solli variantet të ndryshme të emrit. Për emërtimin "Voila" kemi qenë unanimit të gjithë, fitoi me 100% të votave.



prezantuese në "Pop Culture" në muajin shtator edhe me kënaqësi pranova. Kjo ka qenë dhe ëndrra ime prej shumë kohësh. Punoj me staf profesionit, me shumë eksperiencë dhe po më japin një mundësi të artë të rritem profesionalisht dhe të mësoj shumë.

A keni patur propozime të tjera për të qenë në tv?

Po. Unë deri tani i kam pranuar të gjitha, pasi më janë përshtatur. Madje kam punuar dhe në produksionin e "Hell's Kitchen" në prapaskena. Më ka ndihmuar shumë të kuptoj se si funksionon produksioni. Nga ekriani duket shumë thjeshtë çdo gjë, por kur je brenda



tv e kupton se sa punë duhet të realizosh projekte televizive.

Cili është pasioni juaj përveç medias vizive?

Baleti dhe sporti. Baletin e kam ushtruar për disa vite, por më pas e lashë.

Ju vini si një nga figurat e reja në këtë televizion. Kush është Xhesika jash-të ekranit?

Xhesi, siç kam dëshirë të me quajnë "J": Është një vajzë e thjeshtë. Nuk i pëlqen make up, vishet sportiv, nuk bën pushime të gjata, është e qeshur edhe në ditë jo të mira, mendon pozitivisht

gjithmonë. Kjo është Xhesi, pra unë. Doni më për Xhesin? (Qesh)

Me çfarë merreni në kohën e lirë?

Më pëlqen të merrem me sport. Me angazhimet e fundit në tv e kam lënë pas dore. Do e rinis së shpejti patjetër.

Jeni pjesë edhe e "Voice Kids". Si ndiheni të jeni e rrethuar nga fëmijet?

Jo, nuk jam pjesë e "The Voice Kids", por bëj intervistat me fëmijët e "The Voice" tek "Pop Culture". Ndihem shumë e lumtur. Kam punuar rreth 1 vit në Angli me fëm-



I huton të gjithë Çiljeta: Ja pse vendos të largohet nga ekriani

Këngëtarja shumë e njohur dhe e dashur për publikun, Çiljeta Xhilaga, e ftuar së fundmi në emisionin 'Soiree', ka rrefyer pse i ka reduktuar daljet në ekran dhe pse është tërhequr nga mediat kohët e fundit. Ajo ka treguar se një ndër arsytet që e ka shtyrë të marrë këtë vendim është mosha. "Padyshim ka pasur vite kur më kanë bezdisur mediat. Ma kanë bërë jetën tmerr, ferr. Nuk është se kam ndonjë kompleks, por vjen edhe me moshë. Më mirë pak dhe saktë."- është shprehur këngëtarja para kamerës. Mesa duket edhe me lajmit që përflietej për të dashurit e saj, Alban Hoxha, ajo ka preferuar të jetë më e rezervuar.

"Është dikush që të do më shumë në botë", Erik Lloshi bën dedikim prekës

Erik Lloshi është një nga këngëtarët më të dashur shqiptar dhe këngët e tij pëlqehen gjithnjë. Këtë herë këngëtari Erik Lloshi ka publikuar në rrjete sociale një foto ku tregon tatuazhin e tij më të ri. Eriku i ka bërë një dedikim mjaft prekës nënës së tij ku shkruan: "Jeton dikush në këtë botë që të do më shumë se veten. Ajo është nëna!", -shkruhet në tatuazhin që artisti ka në krahun e tij. S'ka si nëna!



Shndërrohet Loredana e Mozikut, pamja do ju lërë pa fjalë!



Këngëtarja e njohur, Loredana, e cila prej pak kohësh është martuar me Mozzik me të cilin ka një vajzë të vogël të quajtur Hana, është mjaft e pëlqyer nga ndjekësit! Hitet e saj i kanë mundësuar bukuroshes mjaft sukses! Po t'i hedhësh një sy të lirë profilit në 'Instagram' të reperes, e cila prej shumë vitesh jeton në Zvicër, vë re lehtësisht se në të shumtën e fotove shfaqet me flokë të kapura. Mandej, në disa foto të tjera shfaqet me flokë të shkurtra bionde pak mbi sup. Por si duket Loredana me flokë të gjatë? Edhe këtë kuriozitet e shuajtëm pasi vetë ajo ka postuar një foto në 'Instastory' ku shfaqet me flokë të gjatë që i shkojnë tej mase! Si duket reperja ka vendosur flokë extension, për të ndryshuar look-un e saj të cilit për shumë kohë i ka qëndruar besnikë! Është rikthyer në superformë!

S'ka shpresa për vajzat e 'Instagramit', këngëtari shqiptar do këtë lloj vajze për veten

Ditët e sotme nuk janë të paktë djemtet që "hutohen" fare nga vajzat e 'Instagramit'. Por Seven Saraçi nuk është një prej tyre. Në 'Instastory', këngëtari ka treguar se cili është saktësisht tipi i vajzës që e tërheq: Ai nuk pëlqen ato që janë gjithë kohën duke bërë poza e duke u rregulluar për fotografi. Me sa duket, preferon dikë më të thjeshtë, e më këmbë në tokë, sigurisht simpatike por që di edhe ta gatuajë. Çfarë saktësisht? Epo, i pëlqen byreku. Postimi i tij tregoi se do një 'çikë të shqipërisë', madje një e cila di të gatuajë edhe pite. Sa vajza do e nisin kursin e gatimit tani?





Varrosi i komenton sa herë s'flet me kreun e OTR? Fansat çmendin me komente modelen

Sherr në 'parajsë'? Oriola dhe Noizy prishin raportet mes tyre

Dikur shumë të afërt, tani jo më, detajet që sjellin dyshimet e zënkës

Pamela Aliaj

Grupi OTR është një nga grupet më të përfolura në vend dhe kjo jo vetëm për shkak të kreut të saj, reperit Noizy, por edhe për shkak të modeleve bukurorshë që janë pjesë e tij. Një ndër të është edhe bukurorshja Oriola Marashi. Ajo është padyshim femra më e bukur shqiptare duke veçuar edhe asetet e saj. Modelja shqiptare u bë e njohur falë reperit, Noizy e cila u bë bashkëpunëtoreshë në grupin e tij "OTR" e së fundmi e kemi parë edhe në klipet e tij. Oriola pati premtuar një këngë, por siç shihet kjo nuk do të ndodhë, pasi dyshja duket se kanë prishur raportin mes tyre. Një nga detajet që u vu re direkt ishte edhe fakti se nëse i kërkojmë në rrjetet sociale, as Oriola e as Noizy nuk e ndjekin më njëri-tjetrin në llogarinë 'Instagram'. Gjithashtu, në komentet e bëra në foton e fundit të postuar nga modelja, e cila del në një pamje tejte provokuese, ndjekësit duket se dinë diçka më tepër lidhur me 'luftën e ftohtë' mes të dyve. Një nga komentuesit ka thënë se është pikërisht Varrosi, krahu i djathtë i Noizyt, ai i cili i bashkon sa herë që Oriola me të zihen. Dhe vërtet nuk para shihen komente të reperit në foto, por sa herë që ka ndonjë zënkë, ai komenton si për të thënë se ajo ende është pjesë e grupit e për të mbyllur 'gojë të liga' për një zënkë mes saj dhe Noizyt. Por faktet tregojnë ndryshe, dhe fansat flasin ndryshe. Pra, kush të jetë vallë origjina e 'sherrit' të tyre? Gjithashtu, kujtojmë se më parë, pjesë e OTR ka qenë dhe këngëtarja e njohur, Enca Haxhia, por për shkak të një konflikti me kreun e grupit, u largua njëherë e mirë për të krijuar imazhin e saj të suksesshëm me këngët e saj ku del tepër provokuese. Edhe pse Encën, ashtu si dhe Oriolën, e bëri të famshme reperit Noizy, ajo vijon ta quajë veten self-made ose e quajtur ndryshe e vetërealizuar. Ndërkaq nga ana tjetër, këto nuk janë të vetmet anëtare femra të grupit. Kujtojmë, gjithashtu, se edhe vajza e këngëtarit të njohur shqiptar, Sabi-



ani, modelja dhe këngëtarja Kejsi Medini, është OTR. Gjithashtu u përfol dhe ende nuk është konfirmuar se edhe këngëtarja Dafina Zeqiri është pjesë e tyre. U përfol për një romancë mes saj dhe Noizyt, së fundmi kur publikuan dhe klipin, "A don love" duke qenë se ishin shumë të afërt me njëri-tjetrin në atë periudhë. Duke iu rikthyer debatit me Oriolën, asnjë nga të dy, po t'i shohim në profilin e 'Instagramit' nuk i ka hequr fotot ku kanë dalë bashkë, që do të thotë se zënka, nëse është reale, nuk është aq serioze, kështu që s'keni pse të shqetësoheni.

Opinion i Ditës

Nga Rexhep Qosja

(vijon nga faqja 1)

...të madhe në historinë e popullit shqiptar. Me emrin e tij është lidhur një fund dhe një fillim në këtë histori: fundi i pushtimit shumëshekullor otoman dhe fillimi i lirisë dhe i pavarësisë shqiptare, sado jo për krejt popullin shqiptar.

Si themelues i Shqipërisë, ai hyn në radhën e atyre personaliteteve që e kanë ndryshuar historinë politike të popullit shqiptar dhe të Ballkanit në përgjithësi.

KARAKTERI I TIJ

Ismail Qemali është njëri nga politikanët me prejardhje shqiptare më të suksesshëm në Perandorinë Otomane, dhe kur thuhet kështu, mendohet në karrierën e tij të gjatë politike e shtetare dhe në ndikimin e tij të madh. Ai i kishte tri parakushte për sukses politik e shtetëror: e para, kishte prejardhje fisnike - çka shikohej shumë në atë kohë; e dyta, ishte aq i pashëm e përshtypshëm në mesin e burrave të tjerë - çka nuk ishte e parëndësishme as atëherë, as më vonë; e treta, ishte aq mendjelartë sa të shquhej fort mes të shquarve - çka çmontoi shumë gjithmonë.

Cilësitë me të cilat e kishte dhuruar natyra apo ishte pajisur gjatë jetës e punës, më parë se ç'kundërshtoheshin, krijonin baraspeshë në personalitetin e tij. Ai ishte modest dhe i dinjitetshëm, i vendosur dhe zemërgjerë, i guximshëm dhe i matur, gojtar e largpamës. Gjykimi i tij i qartë, sjellja e tij e avashitë dhe shija e tij e sigurt e bënin sipëror dhe magjepsës personalitetin e tij. Me veprimin e tij të njohur, ai ishte zotëruar i situatave dhe, siç është thënë bukur për të, zotëria i kohës.

Në pozitë të lartë a pa të, i pasur a i varfëruar, i adhuruar a i shpërfillur, i mbrojtur a i dënuar, në Atë dhe në mërgim, ai ishte nuk e kurdo Ismail Qemal Vlora.

KARRIERA E TIJ


Në sajë të cilësive të sipërthëna, Ismail Qemali do të arrijë të bëhet denjtar i lartë në Perandorinë Otomane.

Por, në sajë të cilësive të sipërthëna, Ismail Qemali do të arrijë të bëhet prijës i Lëvizjes Kombëtare Shqiptare, themelues i shtetit shqiptar dhe kryeministër i Shqipërisë - të gjitha këto aty ku, zakonisht, zogoriti e mediokriteteve ndodhën kënaqësi të madhe në përmbysjen e gjënies!

Gjatë, gati gjysmëshekulli të veprimtarisë politike e shtetare në Perandorinë Otomane, ai do të arrijë të jetë sekretar i Përgjithshëm në Ministrinë e Punëve të Jashtme, por edhe i caktuar ministër i Jashtëm, ministër i Punëve të Brendshme a i Drejtësisë; prijës a pjesëmarrës në misionet e ndryshme politike e diplomatike të Perandorisë në vende të Evropës; Kryetar i Komisionit Evropian të Danubit; këshilltar a sekretar i kryeqeveritarëve në vilajete; prefekt në qytete të mëdha a kryeqeveritar në krahina të mëdha të Perandorisë; kryetar i Dhomës së Deputetëve, por nuk e pranonte titullin pasha sepse e shihte si diçka të tejkaluar.

Njohja e gjendjes politike e shoqërore dhe përvoja e madhe shtetare do ta bëjnë disa herë të përzgjedhurin e sulltanit për reforma shtetërore. Cilësitë e lartshkuara do ta bëjnë, njëkohësisht, edhe të dëshimtarin a të dënuar të sulltanit, para të cilit ai do të ketë guximin t'i shfaqë shpengueshëm mendimet. Domethënë: cilësitë që do ta bëjnë të mundshme karrierën e tij, do të bëhen edhe shkak u smirës, që do të zgjojë të politikanin e diplomatë dhe i përndjekjeve që do të pësojë, duke qenë i çuar në mërgim, i privuar pasurisë dhe i dënuar me vdekje.

Ismail Qemali shembulli historik



BESIMI I TIJ POLITIK

Të dhënat që dihen për jetën dhe veprimtarinë politike e shtetare të Ismail Qemalit, kujtimet e tij dhe kujtimet e të tjerëve për të e kallëzojnë njëri me formim të gjithanshëm dhe me kulturë të gjerë, çfarë ishin shumica e intelektualëve shqiptarë të Rilindjes Kombëtare. Në mendjen e tij kishte vend për të gjitha kulturat, kurse në zemrën e tij vend për të gjitha racat, të gjitha kombësitë dhe të gjitha besimet.

Megjithëse atdhetar i përkushtuar dhe krijues i shtetit shqiptar, ai kurrrë nuk do t'i keqpërdorë ndenjat kombëtare për qëllime politike. Megjithëse mysliman për nga besimi, ai do të kalojë jetë të lumtur me gruan e besimit të krishterë dhe të kombësive të tjerë.

Megjithëse politikanin e diplomatit në një Perandori në të cilën sundonte despotizmi oriental, me bindje e me sjellje ai ishte demokrat liberal. Marrëveshja ishte mjeti i tij politik, toleranca ishte mënyra e sjelljes së tij, humanizmi ishte etika e tij, liberalizmi ishte koncepti i tij për shtetin dhe shoqërinë.

Ai mbroti të drejtat e njeriut në një kohë kur nuk kishte mbrojtje të tyre të ligjësuara dhe në kushte në të cilat aq shumë shkeleshin ato më shumë vende në botë.

Ai punoi për lirinë e cerkezëve që trajtoheshin skllëvër; ai merret me vendosjen në Perandorinë Otomane të hebrenjëve të dëbuar dhunshëm nga Rusia. Kudo është i caktuar për qeveritar në Perandori, Ismail Qemali bën përpjekje të asnjanshëm pasojat e sundimit despotik dhe të ushtrijve pushtetin si pushtet të ndërgjegjes.

Liberalizmi i Ismail Qemalit ka më shumë se një burim. Burimi i parë është shkollimi i tij. Në gjimnazin e njohur Zosimea të Janinës ai do të mësohet "të jetojë - si thotë vetë - në frymën e lirisë të botës së vjetër greke" dhe do të përvetësojë ide liberale të Volterit, Rusos e Lokut.

Burimi i dytë janë njohuritë që kishte për Evropën Perëndimore. Ai qëndron shpesh, më shkurtyrë a më gjatë, në Angli, në Francë e në Itali, ku njih organizimin shtetëror, sistemin ekonomik, filozofinë politike, qytetërimin e tyre.

Burimi i tretë i liberalizmit të Ismail Qemalit është kultura e tij poli-

tike dhe historike. Ai e di se vetëm shtetet demokratike janë shtete historikisht të qëndrueshme. Ai thekson se shovinizmi shtetëror, politik, kombëtar dhe fetar është varrtar i shteteve. Ai thekson se "do perandori që është krijuar me shpatë në të njëjtën kohë ka mbjellë edhe farën e shkatërrimit të vet". Per këtë arsye, për rregullimin shtetëror ai e çmon "forcën morale më të fuqishme se forcën e armatosur" por, natyrisht, forcën morale të mbështetur në ligje demokratike.

VEPRA E TIJ HISTORIKE

Me bindje të tilla, liberale, të cilat ishin bërë shkak u përndjekës së tij, Ismail Qemali do të hyjë në Lëvizjen Kombëtare për krijimin e shtetit shqiptar. Por, bindje që kishte dhe cilësitë me të cilat shquhej do ta bëjnë shpejt prijësin e Rilindjes Kombëtare përpara tij, që kishin vdekur në mërgim, një kohë edhe ai do të mendojë për zgjidhjen e çështjes kombëtare përmes autonomisë në gjirin e Perandorisë Otomane, por të Perandorisë së shqendëruar në federatë të kombeve. Do të mendojë kështu sepse e dinte se disa nga fuqitë e mëdha, e, sidomos, Britania e Madhe, ishin të interesuara që kjo perandori të mbahet si një nga faktorët për mbajtjen e baraspeshës së tyre.

Evropa, ndërkaq, po i afrohej luftës botërore, kurse tronditjeve që do të sjellë ajo po u afrohej edhe Perandoria Otomane. Kur do të bindet se kjo Perandori po përmbysje dhe se me përmbysjen e saj mund të përmbysje edhe shpresa e shqiptarëve për krijimin e shtetit të vet, kur do të bindet se fqinjët ballkanikë me luftë do t'i copëtojnë tokat shqiptare, domethënë kur do të bindet se çasti historik për veprim të vendosur historik kishte ardhur, Ismail Qemali do të zëvendësojë idenë e autonomisë me idenë e pavarësisë së Shqipërisë. Njëkohësisht ai do të ndryshojë edhe idenë për mjetet që do të duhej të përdoreheshin për sendërtimin e asaj pavarësisë: në vend të luftës politike - si i vetmi mjet, ai tani do të kërkojë luftë të armatosur - si mjet kryesor.

Rrjedhimisht, veprimtaria e tij përqendrohet e para, në bashkimin e të gjitha forcave mendore, morale e vepruese kombëtare për atë luftë dhe, e dyta, në sigurimin e mirë-

uptimit të Fuqive të Mëdha për kërkesën shqiptare. Sikundër shihet, formulës së tij politike gjithnjë realiste, Ismail Qemali tani do t'ia shtojë edhe përbërësin idealist. Gje-niu i tij politik e çmon se ajo më e dëshiruara, ajo e mundshmeja, tani ka mundësinë të bëhet e sendërtueshme. Dhe, më 28 nëntor 1912 ai mblehd në Vlorë Kuvendin Kombëtar, i cili shpall pavarësinë e Shqipërisë, i cili zgjedh Qeverinë e Përkohshme dhe i cili e zgjedh Atë, Ismail Qemalin, kryeministër të saj.

Ky ishte shtet ende pa kufij, pa forca të rendit, pa ushtri, pa administratë kombëtare, pa ekonomi, pa financa - shtet pa kushte shteti. Por, ky shtet i porsalindur, megjithatë, kishte dinjitetin politik, juridik dhe moral të shtetit: institucionet e tij shtetformuese - Kuvendi dhe Qeveria, ishin sovraane në një pjesë, sado e vogël qoftë ajo atëherë, të Shqipërisë së ardhshme. Qeveria e Përkohshme, me në krye Ismail Qemalin, liberalin që ishte i bindur se virtytet shpirtërore duhet të jenë arma kryesore e saj, do të bëjë çmos që Shqipëria të shtrihet deri atje deri ku ishin kufijtë e saj etnikë dhe që të jetë, vërtet, e pavarur dhe e qëndrueshme. "Për fat të keq - do të shkruajë Ismail Qemali më vonë në Kujtimet e tij - ashtu si ndjek njerëzit e veçuar, Fati ndjek dhe popujt".

DËSHPËRIMI I TIJ

Atë ditë të madhe, më 28 nëntor, kur fillon jeta e Shqipërisë së pavarur, atë ditë fillon edhe eja e saj, e krijësisë të saj dhe e popullit të saj nëpër mundime. Shqipërisë do t'i shkaktohen të këqija, cenime, përipeci, prej fqinjëve ballkanikë, prej disa fuqive të mëdha evropiane, prej klasës së vet politike, prej trashitësve njerëzore. Luftërat Ballkanike dhe, menjëherë në vazhdim të tyre, Lufta Botërore, në të cilën për interesa të kundërta të Fuqive të Mëdha e të të mbrojturve të tyre të vegjël do të derdhet aq shumë gjak, do të shtojnë numrin e shkaktarëve të peripecive të Shqipërisë e të tragjediave të shqiptarëve. Konferenca e Ambasadorëve në Londër do t'i sjellë dëshpërim të madh popullit shqiptar dhe Ismail Qemalit. Jashtë kufijve të Shqipërisë ajo do të lërë më shumë se gjysmën e trojeve shqiptare dhe më shumë se gjysmën e popullit shqiptar! Serbisë, Malit të Zi dhe Greqisë do t'u jepen fushat më pjellore, burime të lumenjve, qytete të zhvilluara shqiptare! Se ç'përmasa ka parrëgjegjësia historike e Fuqive të Mëdha në këtë Konferencë shihet në rastin e Kosovës e të Maqedonisë: ato do t'i jepen Serbisë edhe pse numri i serbëve që jetonin aty ishte gati i padukshëm!

Serbia i vazhdon përpjekjet për të dalë në det përmes Shqipërisë dhe një kohë e mban të pushtuar një pjesë të saj! Mali i Zi bën çmos të rikthejë Shkodrën dhe gjithë Ulcinën e saj. Greqia pushton pjesën jugore të Shqipërisë dhe nuk heq dorë prej synimeve për përshtirje sa më lart në veri!

Italia bën politikën e pushtimit të Vlorës e të Sazanit dhe të vënies së Shqipërisë nën protektoratin e saj! Rusia e Franca, madje edhe Britania e Madhe, shteti - shpresë i Ismail Qemalit, shikojnë si ta bëjnë Serbinë sa më të madhe, kurse Franca nuk do të ngurrojë ta shpërblejë Greqinë me qytete shqiptare, si, fiala vjen, me Korçën!

Esat Pashë Toptani krijon kundërqeveri në Durrës, zhvillon fushatë të hapur me shpifje djallëzore kundër Ismail Qemalit dhe vihat në shërbim të Serbisë! Anarkia e brendshme, që shfaqet

gjithmonë e gjithkund pas rënies së sundimeve të gjata të dëshnmë, varfëria, analfabetizmi i shtrirë dhe zia e bukës bëhen, po ashtu, rrezik për Shqipërinë dhe për qeverisjen e saj!

Fati i Shqipërisë dhe i Babait të saj ishin bërë Njësh.

I gjetur nën trysninë e Fuqive të Mëdha për arsye se donte të ishte subjekt e jo objekt i historisë, i braktisur nga bashkëpunëtorët arivistë, i pa kuptuar nga një pjesë e madhe e bashkëkombësve, i shpërfollur e i akuzuar rrejtshëm nga intrigantët, i lodhur nga mosha, i push-tur nga një mosbesim për mundësinë e ndryshimit të shpejtë të gjendjes, Ismail Qemali më në fund lë Shqipërinë dhe rishtazi merr rrugën e mërgimit. Peshë mbi krahët e tij kishte qenë shumë e rëndë dhe ai nuk kishte mundur ta çonte më tutje. Si njeri që nuk dorë-zohej lehtë ai, megjithatë, do ta vazhdojë luftën për Shqipërinë atje ku e kishte filluar: në qendrat politike evropiane. Kjo luftë tani nuk do të zgjasë shumë: perdia në fund të Dramës së tij jetësore do të bëjë më 26 janar 1919. Shqipëria me kufij të caktuar në Konferencën e Londrës më 1913 do të mbahet, por perdia në fund të dramës shqiptare nuk do të bjerë aq shpejt. Kjo dramë do të vazhdojë të luhet gjatë gjithë shekullit njëzet e, në kushte të tjera e në mënyra të tjera, me mundësi e me shpresa të tjera, vazhdon diku diku të luhet edhe sot në fatin historik të shqiptarëve.

Nuk jam profet që ta di edhe sa kohë do të luhet kjo dramë. Shqiptarët kanë shumë arsye që t'u jenë mirënjohës përgjithmonë SHBA-ve dhe BE-së për të gjitha ato që kanë bërë për të ndalë dhunën shfarfese serbe kundër tyre në Kosovë në vitin 1999 dhe për të gjitha ato që vazhdojnë t'i bëjnë për mbrojtjen e paqes në Kosovë. Por, nuk mund të mos thuhet se regjisorët e tragjedisë historike shqiptare në Kongresin e Londrës (1878), në Konferencën e Berlingut (1913) dhe në Konferencën e Paqes në Paris (1919) - shtet e media evropiane, po e degjojnë të rrrulura e të shprehura të shprehura shqiptare ende të pazgjidhur përfundimisht, domethënë historikisht. Megjithëse për të janë shumë më të vëmendshme sesa paraardhësit e tyre para gjatë një shekulli, zgjidhjen e saj vazhdojnë ta lënë ende të pakryer para së gjithash duke e kundërshtuar bashkimin e Kosovës me Shqipërinë! E çështjet si kjo për të cilën është fjala këtu, kur lihen përgjysmë të zgjidhura, lënë mundësi për tendosje e konflikte.

Por ta përfundoj këtu fjalë.

SHMBULLI I TIJ

Emri i Ismail Qemalit në historinë e popullit shqiptar mbetet përgjithmonë i shënuar si shtetari, që themeloi Shqipërinë; si demokrat liberal, që e filloi qeverisjen demokratike në jetën kombëtare dhe si njeri, që dhunë dhe të politikë e përdori në mënyrat më të denja për punët më të rëndësishme - domethënë mbetet i shënuar si personalitet, që ka kryer mision prijës e parathënë në këtë histori. Është e kuptueshme pse pikërisht populli, njerëzit e thjeshtë me të cilët është përfunduar ai, e kanë vlerësuar aq bukur këtë mision kur e kanë kënduar në vargjet:

Unë jam Ismail Qemali Pas meje vjen historia.

Lavdia e pa kaluar politike e shtetare meritohet edhe në sajë të dhuntive e virtyeteve që e shquajnë Ismail Qemalin: në sajë të kultures çfarë e kishte Ai; në sajë të forcës morale, me të cilën i duronte tundimet e fatkeqësitë Ai; në sajë të ndershmërisë me të cilën shquhej Ai; dhe në sajë të sakrificave që për Atëdhunë e vet i bënte Ai.

Ai, i cili, si rilindësit e tjerë të mëdhenj, të gjitha pasuritë e veta lëndore, mendore, shpirtërore, e la dhuroi popullit të vet.

Ai - Ismail Qemal Vlora - shembulli i madh i njeriut, i politikanit dhe i shtetari në historinë e popullit shqiptar.

Opinion *i* Ditës

Kosova duhet të flasë gjermanisht

(deri në raportin e Robert Mueller)

Nga Berat Buzhala

(vijon nga faqja 1)

...bërë me dije edhe komentatorëve që analizat e tyre për krizën e fundit në vend nuk po kalojnë pa u vërejtur, për të mirë ose për të keq.

Të polemizosh me ambasadën amerikane, ose Zoti mos e dhashë, ta kundërshtosh ambasadën amerikane, ka qenë vetëvrësja më e sigurt politike. Ne që jemi që një kohë pjesë e debateve publike, ose që e përcjellim politikën që 15-20 vjet, mund t'i numërojmë me precizitet varret e atyre që e kanë humbur jetën (metaforikisht), kur e kanë kundërshtuar një pikëpamje amerikane, ose një interes amerikan.

Amerikanët çka mendojnë për këtë punë?

Ata nuk po pajtohen!

A po a, i paska vdekë nana kësaj pune - le kreyt, mos u bon budallë.

Kaq të thjeshta dhe të qarta kanë qenë gjërat, prej së paku vitit 1992, kur në skenë kishte dalë për herë të parë George Bush i Vjetër, duke e kërcënuar Sllibodan Millosevicin që të mos e shkelte vijën e kuqe në Kosovë, në atë që tash njihet si kërcënim i Krishtlindjeve.

A na ka ra keq ndonjëherë që e kemi dëgjuar Amerikën?

Jo, jo.

Ami mbylle pra, mos e zgjat.

Këqyre çka e gjet Nexhat Dacin që u prish me amerikanë.

Dhe vërtet, në përgjithësi kësh-tu ka qenë. Pas Bushit të vjetër erdhi Klintoni i ri. Në Kosovë ky ndryshim na kishte frikësuar paksa. Na duke pak axhami krahasuar me reputacionin e Ronald Reaganit, një antirus i përbotur, i cili thuhet që e kishte fituar mandatin e dytë me reklamën dedikuar Bashkimit Sovjetik "There is a bear in the woods", pastaj reputacionin e Bushit të Vjetër, posaçërisht pas Stuhisë në Shkretëtirë, kur për disa ditë e gjunjëzoi aleatin e Rusisë në Lindje të Mesme, Irakun. Mirëpo frika jonë doli të ishte e ekzagjeruar. Billi i ri, lozonjar, kur ishte në pyetje mbrojtja e nderit të Shteteve të Bashkuara të Amerikës, qoftë në Ballkan, apo edhe në vende të tjera të botës, ishte po aq i vendosur dhe po aq patriot sa edhe Regan e Bush, e Bushi i Ri e Obama. E ndoshta nuk e kishin fatin që të ishin president, por do të ishte mëkat që të mos ishin këtu në këtë mes edhe Robert Dole, Joe Biden, McCain, Albright, Holbrook etj.

Amanet: Me Amerikën edhe me Zotin mos u prish!

Përpara se të filloja ta komentojam një komunikatë të ambasadës së Shteteve të Bashkuara të Amerikës, të publikuar sot pasdite, ia rikujtova vetës në pika të shkurtta këto dromca nga e kaluara e jonë me këtë superfuqi. Mirëpo, fatkeqësisht, asnjë nga këto nuk mjaftoi që unë të vazhdoja ta mbaja gojën e mbyllur. Këtë herë është ndryshe. Këtë herë Amerika ka nevojë për ndihmë, ndoshta më shumë se sa kemi ne.

Të rikthehem tash te komunikata.

Kjo është ndoshta hera e parë që ambasada amerikane i komen-



ton, përveç politikanëve, edhe komentatorët. Jam paksa i frikësuar që kjo nuk do të jetë hera e fundit. Trendi më i ri, i vendosur nga presidenti amerikan, në kundërshtim flagrant me vlerat e vërteta amerikane, siç është liria e plotë e medias - madje edhe liria për ta pasur gabim - nuk është shprehëdhënëse. Sido që të jetë, ne si gazetarë, por edhe si komentatorë, vazhdojmë që ta kemi pikë referuese demokracinë amerikane, minus Presidentin Trump dhe rrethin e tij të ngushtë, që në afat rekord është duke e minuar një punë të ndërtnuar me sakrificat të mëdha, për më shumë se 200 vjet.

Tash të kthehem konkretisht në temën për të cilin edhe u lëshua komunikata: marrëveshja përfundimtare në mes të Kosovës dhe Serbisë, e orkestruar nga Presidenti Thaçi dhe Presidenti Vuçiç, dhe si duket - e aprovuar edhe nga Shtëpia e Bardhë.

Personalisht, si komentator, e konsideroj krejtësisht të rrezikshme dhe me pasoja të mëdha për vendin tonë, por edhe për rajonin, idenë e dy presidentëve, që për t'i rënë shkurt problemit i kanë rikthyer në tryezë idetë e shekullit të kaluar, të cilat sa herë janë përdorur kanë sjell vuajtje dhe gjak. Nuk e di pse dikush duhet ta bëjë prapë të njëjtën rrugë për të shkuar te i njëjti rezultat? Kanë qenë vitet e 90, lufta në Bosnje dhe Hercegovinë sapo kishte nisur, kur presidenti serb, më i madhi kriminel në Evropë që nga Adolf Hitler, dhe Presidenti kroat Franjo Tugmanin, ishin argëtuar me idenë e zgjidhjeve të shpejta dhe "efikase" në mes këtyre dy etnive, me rivizitim të kufijve. Kemi qenë dëshmitar okular të rezultateve të kësaj ideje. Qindra mijëra civilë të vrarë dhe miliona të shpërngulur. Pas këtyre skenave të horrortit, ka pasuar një përkushtim i pasqor i administratave të katër presidentëve amerikanë, Bushit të vjetër, Klintonit, Bushit të Ri, Obamas, që t'i shmangën tundimit të krijimit të shteteve etnike.

Pastaj, ndoshta është e kotë ta ripërsërisim se autorët e kësaj ideje, Thaçi dhe Vuçiç, janë çdo gjë

tjetër përveç liderë kredibilë. Që të dy këta, për aq vite sa i sundojnë banorët e shteteve të tyre, kanë demonstruar zell për autoritarizëm, keqeverisje dhe korrupsion. Kredibiliteti i tyre, për çfarëdo gjëje, e edhe për paqe, ka kohë që është komprometuar.

Mirëpo ky nuk është problemi i vetëm. Aq sa janë shqetësues akterët lokalë, aq është shqetësues edhe akteri kryesor global, në këtë rast Presidenti Trump dhe këshilltari i tij për Siguri Kombëtare, John Bolton.

Ne të gjithë jemi dëshmitarë të zhvillimeve dramatike për, dhe rreth, fatit të Presidentit Trump, posaçërisht në kontekstin e hetimeve për lidhjet e tij me Rusinë, për zgjedhjet e fundit (sot u arrestua një bashkëpunëtor i ngushtë i tij) të cilat po zhvillohen nga prokurori Robert Mueller.

Ajo çfarë kemi parë deri më tash, dhe kemi lexuar, për Presidentin Trump dhe rolin e tij në kontinentin Evropian nuk është aspak shprehëdhënëse për ne. Agjenda e tij anti evropiane është e paprecedent në 100 vitet e fundit. Dëshira e tij për ta dobësuar Bashkimin Evropian, për të provokuar kriza, për t'i mbështetur partitë radikale nacionaliste në kurriz të partive liberale evropiane, për t'i anatemuar emigrantët, janë vetëm disa prej angazhimeve të tij, ose të deleguarit të tij joformal për Bashkim Evropian, Steve Bannon.

Trump misionin e tij anti-Bashkim Evropian e kishte nisur duke u bërë palë agresive në debatin e zhvilluar në Britani të Madhe, të njohur si Brexit, duke u rreshtuar në krah të një politikani si Nigel Farage, duke e sulmuar hapur Kryeministren e Gjermanisë Angela Merkel, apo edhe mbështetja që ai u jep figurave më joemblematake në BE, siç është Kryeministri i Hungarisë Viktor Orban, apo flirti me Marin Le Pen në Francë dhe Salvini në Itali - të tretë këta që i përmenda ironikisht janë mëqë edhe të Presidentit Putin. Të mos flasim pastaj për qasjen e tij ndaj NATO-së, dëshirën e tij që SHBA

ta braktisë këtë aleancë. Kurse asnjëherë deri më sot nuk e ka fshehur admirimin që e ka për vozhdën rus. Historikisht Ballkani ka qenë thembra e Akilit për kontinentin Evropian. Prandaj asgjë nuk do ta dobësonte më shumë Bashkimin Evropian se sa një konflikt i ri në këtë territor. Është e tepër të thuhet se këtu ka filluar një Luftë Botërore, e sa e sa luftëra të tjera rajonale me pasoja shumë më të gjëra. Prandaj t'i qasesh sot zgjidhjes së problemit të Kosovës me Serbinë, në një formë kaq blatante, dhe kaq të patak, është pak a shumë sikur të provosh të lavrosh arën me tren. Problemet e Ballkanit janë aq delikate, sa secila prej fijeve të problemit e ka një histori të komplikuar. Prerja e secilës prej fijeve, duke e konsideruar të kotë, mund ta çojë në ajër gjithë rajonin. Kështu që Trump, dhe administrata e tij, nuk e kanë as ekspertizën e as memorien për këtë rajon dhe për problemin këtu. Kjo bëhet edhe më dramatikë nëse kihet parasysh që pjesë e procesit të zgjidhjes së problemit në mes të Kosovës dhe Serbisë nuk janë aleatët tradicional të Kosovës, siç janë Gjermania dhe Britania e Madhe. Të vetmit të interesuar për ta rihapur nga e para problemin e Kosovës, për ta shtruar për diskutim, duken rusët dhe serbët. Mirëpo, rusët janë shumë më të interesuar për ta hapur se sa për të mbyllur problemin e Kosovës, në mënyrë që në Evropë të hapet edhe një problem më tepër dhe në mënyrë që Rusia ta ketë edhe një chip më tepër në pokerin global. Kurse Serbia në anën tjetër, çfarëdo dialogu të këtyre përmasave që do ta nisë me Kosovën, do ta propagojë të shtetet që nuk e kanë njohur pavarësinë e Kosovës, e edhe te ato që e kanë njohur se "kjo është një çështje e hapur".

Pra, pyetjet që shtrihen janë këto: Çfarë nëse nuk arrihet kjo marrëveshje historike? Çfarë nëse palët nuk pajtohen? A do të thotë që statusi i Kosovës mbetet i hapur përsëri? A do të thotë që bisedat dhe tentativat për paqe do të vazhdojnë pafundësisht? A do të luftojmë pastaj për t'i rifituar ato fshatra që i kemi dhënë?

Janë shumë pyetje që askush nuk ka përgjigje. Nuk i ka as administrata e Donald Trump. Kjo administratë në këto dy vite nuk ka zgjidhur probleme. Ajo ka shkaktuar probleme, posaçërisht në Bashkimin Evropian. I vetmi shtet i kënaqur me këtë administratë është Rusia, e cila tash e disa kohë nuk ka nevojë të bëjë asgjë. As të kritikojë NATO-n, as Bashkimin Evropian e as Shtetet e Bashkuara të Amerikës. Ka kush e bën këtë.

Kështu që e gjitha bota demokratike, bota demokratike e ndërtuar pas Luftës së Dytë Botërore, ajo liberale, po e pret vetëm një gjë: Raportin e Robert Mueller. Atë duhet ta presim edhe ne. Deri kur të zbardhet ai raport, i cili do të zbardhë shumëçka, Kosova nuk duhet ta heqë taksën ndaj Serbisë, Kosova nuk duhet të bëjë asnjë përparim drejt arrijtes së një marrëveshje finale me Serbinë. Kosova duhet të flasë gjermanisht.

HOROSKOPI

DASHI

Mos u befasoni kur të merrni disa lajme pozitive nga një burim jo fort i besueshëm sot. Përpikuni të shfrytëzoni në maksimum kohën tuaj për t'u vënë në qendër të vëmendjes.

DEMI

A keni nevojë për më shumë frymëmarje në jetën tuaj? E pra, sot është koha e duhur! Gjërat gjithsesi po fillojnë të çlirohen në jetën tuaj dhe njerëzit e duhur do të dëshirojnë të jenë me ju.

BINJAKET

Sot ju do të kuptoni më mirë rolin tuaj në komunitet. Në një kontekst familjar, marrëdhëniet do të bëhen më të ngrohta. Në punë ose në shkollë, roli juaj do të rritet dukshëm.

GAFORJA

Sot lajmet që do të merrni në lidhje me një aplikim do t'ju zhyjnë në mendime. Ky nuk është momenti për të hequr dorë, përkundrazi, për t'u fokusuar më shumë në arrijten e suksesit.

LUANI

Nëse e kaloni gjithë kohën duke menduar mbi aspektet pozitive dhe negative të jetës, do të humbini cilësitë e veçanta dhe të papërcaktuara të kësaj dite. Imazhi publik është i rëndësishëm sot, prandaj buzëqeshni.

VIRGJERESHA

Ju duhet ta ktheni të gjithë vëmendjen drejt biznesit sot. Lëvizni përpara në negociatat tuaja, por veproni në mënyrë konservative. Mbani në mend se kjo situatë nuk është një lojë pokeri. Ndershmëria dhe integriteti janë një pjesë e natyrshme e juaja.

PESHORJA

Vetëm për shkak se ekziston një konflikt në jetën tuaj tani nuk do të thotë se duhet të lini gjithçka menjëherë. Disa gjëra mund të rregullohen shumë lehtë.

AKREPI

Ka ardhur koha që të fokusoheni më shumë të vetja sesa tek të tjerët. Bani një inventar të gjërave që kanë funksionuar apo dështuar në jetën tuaj. Në dashuri duhet të mendoni për më shumë angazhim.

SHIGJETARI

Një energji e mirë ju mbush me entuziazëm sot. Shfrytëzoni këtë moment për të realizuar ndonjë projekt që ju ka mbetur në mendje. Mos harroni se kur rrethoni nga optimizmi dhe shpresa, gjërat realizohen më mirë.

BRICJAPI

Sot do të ishte një ide e mirë që të tërhiqeni nga angazhimi e shumta dhe të relaksoheni pak. Dëshira për të arritur më shumë është e admirueshme, por ju duhet të vlerësoni edhe faktin se deri ku keni shkuar aktualisht.

UJORI

Ekziston një mister që dëshironi ta zgjidhni në jetën tuaj. Dikush që zakonisht nuk e merrni shumë seriozisht, do të flasë për disa të vërteta që mund t'ju fusin në mendime. 'Qentë' e vjetër mund të mësojnë truket e reja dhe ju duhet të mësoni se si t'u jepni njerëzve një shans të dytë, ose edhe të tretë.

PESHQIT

Derisa të keni një pasqyrë më të qartë të asaj që po ndodh rreth jush, nuk do të jeni në gjendje të shkoni përpara. Të kalosh nga një vend tek tjetri do të jetë një sfidë për ju sot. Lajm i mirë është se ky kufizim mund t'ju ndihmojë të hiqni gjërat që nuk dëshironi të bëni!

DREJTORI I PARTIZANIT

Drejtori sportiv i Partizanit, Olsi Rama, foli për "Supersport" pas fitores me Skënderbeun në Korçë, nga ku deklaroi se tashmë i pëlqen serioziteti dhe përgatitjet e Partizanit, për këtë gjysmë të dytë të sezonit. "I kënaqur nga fitorja në Korçë, ka gjithmonë bukurinë e vet. Unë e kam thënë, do i shoh vetëm 2-3 javët e fundit. Tani, luftën e kemi me veten tonë, të fitojmë ndeshjet e radhës.

Rama: Titulli? Do të flasim vetëm në fund të sezonit



Kam parë seriozitetin e ekipit në Antalia, kemi bërë mirë në ndeshjet stërvitore në Antalia,

edhe sot luajtëm si ekip. Terreni i vështirë nuk na lejoi të dilnim në lojën tonë. E pritëm kundërshtarin, dhe dolëm përpara me kundërsulm. Lojtarët e rinj? Duka ka një problem muskular, në fushë do luajë kush ta meritojë. Lum Rexhepi tregoi karakter e cilësi në fushë, mendoj se është një vlerë e shtuar.

PRESIDENTI I SKËNDERBEUT

Takaj: Nuk ka mbaruar ende asgjë, humbëm një ndeshje

Presidenti i Skënderbeut, Ardit Takaj foli për mikrofonin e "Supersport" pas humbjes në shtëpi ndaj Partizanit ku u shpreh: "Loja nuk diskutohet që do ishte e vështirë sepse terreni nuk ta lejoi. Megjithatë ky nuk është justifikim. Humbëm një ndeshje, siç kemi fituar 2 të tjerat. Rezultatet negative nuk po ndalen. Sot (dje) ndikuan mungesat. Ky është një ekip si ai i vjetshmi. Janë lojtarët e rinj. Nuk



mund të jetë një Skënderbeu gjithmonë në krye. Normal-

isht nuk mund të ishte i bukur futbollit! Futbollit është i bukur sepse ka rezultate, ka garë dhe bëhet monotone në ofrë se një ekip del gjithmonë kampion. Megjithatë gara do të vazhdojë. Kampionati do jetë i fortë. Nuk është se filloi dhe mbaroi të kjo ndeshje. Ashtu siç kemi fituar ne 2 ndeshje me Partizanin, fituan dhe ata sot".

Kryendeshja e javës së 19-të i pati të gjitha, nga penalltia e humbur e Telushit, te i kuqi i Trashit

Partizani "mbret" në dëborë, Skënderbeu, kriza nuk ka fund


Mala vulos fitoren e parë në këtë sezon ndaj korçarëve



Jeton Selimi

Partizani bën detyrën. Mposht Skënderbeun dhe e lë 10 pikë pas, shkëputet 6 pikë nga Kukësi dhe thyen tersin pasi në dy sfidat e para bardhekuqtë kishin siguruar pikët e plota. Një ndeshje emocionuese që i pati të gjitha. Gola, tension, penallti të humbura dhe karton të kuq, si për të treguar se jo më kot kjo sfidë ka qenë më e zjarrta e viteve të fundit në superligë. Të kuqtë i janë falur golit të shpejtë të Esat Malës, të cilin kanë mundur ta ruajnë deri pas minutës së 97-të, kur gjyqtari Andi Koçi vërshëlleu tre herë për të kurorëzuar trimfun e kryeqytetasve.

Ndeshja në Korçë nis me temperatura të ulëta dhe një terren të vështirë, por kjo nuk i pengon skuadrat që të japin maksimumin. Skënderbeu e nis menjëherë në sulm, por i pari shënon Partizani. Një kombinim i bukur mes Trashit dhe Asanit dhe shkupjani jep një asist fantastik për Esat



Malën, që në shtyllën e dytë nuk gabon duke çuar në ekzistencë tifozërinë kryeqytetase. Ekipet përpiqen të vënë rregull në fushë, por nuk heqin dorë nga sulmet. Në minutën e 13-të gjyqtari Koçi do të ndërpresë ndeshjen pasi tifozëria vendëse do të nisë të gjuajë me topa bore në fushë. Muzaka dhe Oto Xhon (minuta 19) nuk merren vesh mes tyre në një rast ideal, ndërsa ajo se çfarë humbet Kardozo në fund të pjesës së parë, detyron Gegën që ta lërë në stol në pushim. Pjesa e dytë do të ketë momentet e saj kulmore, fillimisht (minuta 53) Telushi humbet një penallti, të cilën e ndaj Teja në mënyrë të shkëlqyer,

ndërsa në të 80-ën sërish mesfushori vlonjat nuk arrin të gjejë kuadratin. Ardit Hila do të jetë i pafat, kur vetëm 20 minuta pas aktivizimit, do të detyrohet të lërë fushën e lojës me ambulancë pas një dëmtimi në shpatull. Skënderbeu do të këmbëngulë për barazimin (92), por nuk do ta gjejë, ndërsa Trashit do të humbasë ndeshjen me Kamzën për shkak të kartonit të kuq të minutës së 95-të. Skënderbeu vijon kështu të konfirmojë krizën që e ka përfshirë, pasi humbet ndeshjen pestë radhazi në kampionat, ndërsa Partizani rikthehet te fitorja pas tre barazimeve.

TRAJNERI I PARTIZANIT

Trajneri i Partizanit, Skënder Gega, foli për "Supersport" pas fitores me Skënderbeun. Arkitekti i këtij edicioni të jashtëzakonshëm për Partizanin, u shpreh i lumtur për fitoren, por edhe për elementet e afruar së fundmi në skuadër që kanë zhvilluar një 90 minutësh shumë pozitiv.



Gega: I lumtur me suksesin, Rexhepi bast i fituar

luajtëm, edhe pse pati disa gabime. Rexhepin, kisha besim dhe e futa. Edhe pjesa tjetër iu gjend afër. Edhe Atanda është një markues i mirë, bëri mirë në mesfushë. Sot po të kthesh kokën, kam luks në stol, lojtarë që do na ndihmojnë shumë.

Rexhepi, një bast i fituar?

Po, është një lojtar me kualitet dhe eksperiencë. Është profesionist. Për aq kohë sa kam pasur mundësi ta studioj. Kam pasur një përqindje sigurie që do bëjë një performancë të mirë. Sot e kaloj me sukses, por nuk i jap dot një notë që në performancën e parë.

Patët vështirësi kur

bëtë ndërrime në një pozicion, Kardozon dhe Hilën?

E vërtetë, te kjo fushë nuk vihet nota teknikisht. Ne çaluum, ashtu si edhe Korça. Ishim përgatitur që ta ndërtonim ndeshjen në kundërsulm. Bëmë maksimumin. Ishim të kënaqur të realizonim atë që kishim punuar. Më erdhi keq për Hilën dhe Kardozon, loja e tij nuk është për këtë terren. I jap merita edhe Skënderbeut, pasi kanë ritëm dhe dëshirë për të luajtur.

Atanda me Telushin shkon më shumë përpara...

Telushin nuk dua ta justifikoj, penalltinë e humbin të gjithë lojtarët. Ai ka qenë me serum, por

egoja dhe shpirti i tij bënë që të jetë në fushë sot. Kemi zgjidhje, në mesfushë me Hilën, Atandën. Kemi 3 qendra në mbrojtje, kemi mesfushorë të mirë. Kjo ndeshje mbaroi tani, dhe do shikojmë për Kamzën.

A u bindtë se ju duhet një sulmues që të mbyllni ndeshjet?

Unë kam 4 sulmues, Bardhi, Asani dhe Mala janë sulmues. Dolëm shumë mirë në sulm sot. E mira nuk ka fund, por nuk e di sa do na bënte një sulmues. Nuk e di çfarë do bëjmë deri në ditën e fundit. Duhet të adoptohet, nëse vjen, jo të na prishë lojën e ndërtuar deri tani. Hila ka nxjerrë shpatullën, besoj se 4 javë do jetë jashtë. Ne nuk nxjerrim njeri jashtë titulli, as ne nuk kemi fituar titullin sot (dje).


Ardit Hila, 4 javë jashtë fushave të lojës

Në minutën e 65-të pati një moment ankthi te skuadra e kuqe, kur mesfushori Ardit Hila dëmtohet në shpatull. Mjekët e ekipit hyjnë që t'i japin ndihmën e parë, por dëmtimi duket i rëndë. Hila, që kishte hyrë në fushë në minutën e 45-të, largohet me ambulancë drejt spitalit, ku pas ekzaminimeve të para konfirmohet dhe shkalla e dëmtimit, që do ta mbajë elbasanasin 4 javë larg fushave të blerta.

SUPERLIGA

TE PREMTEN	Skënderbeu - Partizani	0-1
TE SHTUNEN	Kukësi - Laçi	14:00
TE DIELEN	Luftëtari - Kastrioti	14:00
	Teuta - Flamurtari	17:00
	Tirana - Kamza	17:00

Fjalëkryqi (1)



HORIZONTAL

1. Eshhtë babëzia.
8. Burton regjisor.
11. Skilavja e Abrahamit.
12. Një dite në mbledhje.
14. Tyson i boksit.
15. Rrethojnë ringun.
17. Beson pa kufij.
19. Zola që shkroi Nana.
20. Eshhtë ankimm.
23. Pak elementarëd
24. Janë me para në bankë.
26. Matet pa kufij.
27. Janë ngrehina për reparte fabrikash.
28. Një zog i verdhë.
29. Inicialet e Moravia-s.
31. Qytet gjerman.
34. Një zonjë që ha gurë.
35. Pak analogji.
36. I ka plasur të paturpit.

37. Janë legjendat.
38. Nuk ka akoma një bebe.
39. Fillojnë mirë.
40. Janë brinjë në skuadër.
42. Shkruhet i shtati.
44. Nqet edhe ajo e mirë
47. Mbahet në gisht.
48. Janë numrat 1, 3, 3...

VERTIKAL

1. Kanë shpate të tilla.
2. Janë edhe ato polare.
3. Janë mizorët.
4. Janë male në Rusi të tilla
5. Eshhtë nusja me vello.
6. Një rreth pa ekstreme.
7. Mbyllin kuvendin.
8. Në kryr të titujve
9. Diku në qendër.
10. Markë cigaresh.
13. Janë rërimet e të pandehurit.
14. Janë penjtë për gjergjef.
16. Mbarojnë fare.
18. Janë sfitët e... provimëve.
20. Mund të jenë fotografikë të tillë.
21. Vitet pa kufij.
22. Një fjalë për tutje.
24. Brown i Kodi i Da Vinci-t.
25. Eshhtë e akuzuara... injorante
26. Baldwin aktor
27. Një pjesë e kandidatëve.
28. Krenar pa çift.
30. Grazia Cucinotta.
32. Paul këngëtar.
33. Janë pëshjtellat.
35. Inicialet e Moravia-s.
37. Pak makinacione.
38. Samuel bomber kamerunas.
40. Markë makine koreane.
41. Ente Kombëtare Durrës.
42. Fillojnë kurat.
43. Inicialet e Zemeckis regjisor.
45. Ekstreme në litar.
46. Fillojnë lejen.


Fjalëkryqi (2)

HORIZONTAL


1. Satelit i Uranit.
6. Eshhtë edhe ai i Pallës.
11. Tiran pa kufij
12. Në krye të armatës.
13. Një Ibrahim violinist.
14. Qendër ditore.
15. Mund të jenë fotografikë.
17. Inicialet e Einstein.
18. Një mbishkrim në kryq.
20. Janë si vite.
21. Thurman aktore.
22. Të parat në irritim.
23. I preu Seneka.
25. Fillojnë ilustrimet
26. Isaac Asimov.
27. Një Vladimir kompozitor.
28. Janë në modë.
30. Janë zyrat... qeveritare
32. Me të nxjerrin trarë.
35. Një shkop, thupër.

VERTIKAL


37. Eshhtë Shqipëria e madhe.
39. U thyen në Salamina.
40. Një raport shumë i ngushtë.
41. Nota e diapzonit.
42. Fund heroi.
43. Një top në rrjetë.
45. Gjysma alarmi.
46. Herët pa zë.
47. Sampras i tenisit.
48. Me to bëjnë triko.
49. Një gjuajtje fluturimthi në tenis.
50. Janë kokrrat e listit.
7. Lindin në kokë.
8. Gjysmë shtegu.
9. Hiden të parat.
10. Eshhtë njeriu i përsosur.
13. Një fjalë për tutje.
15. Fundi i një samurai.
16. Mbyllin me epilop.
17. Bel i maupassant.
19. Inicialet e Redford.
23. I manifeston nxënësi i papërgatitur.
24. Në hyrje të tokës.
26. Pak impresioniste.
27. Janë metrat në sipërfaqe
29. Hapet një për ajër.
30. Gjysmë krenar.
31. Një hidrokarbur.
33. Vrau Hektorin.
34. Një film i rixhiruar.
36. Kupat pa kufij.
38. Inicialet e Nolte aktor.
41. Ullimann aktore.
43. Një brilantinë moderne
44. Hotel pa kufij.
46. Ekstreme në hall.



Gjeni ndryshimin



Dy figurat kanë ndryshime nga njëra-tjetra



Përgjigja, ja cilat janë ndryshimet e figurave

PËRÇJIGJET E FJALËKRYQJEVE TË NUMRIT TË KALUAR

P	E	T	R	I	K	A	A	S	P	A	K
T	R	U	P	T	A	L	E	N	T	I	A
T	R	E	L	P	A	N	T	E	R	A	T
B	A	K	U	N	I	N	A	N	E	M	I
T	A	M	A	R	O	C	I	I	H		
P	I	E	E	N	A	O	D	R	E		
A	C	T	O	N	E	K	K	A	O	S	
R	A	T	R	A	D	E	A	L	M	A	
K	E	M	A	P	E	T	E	E	A	P	
E	L	S	A	V	A	L	L	R	O	N	E
R	I	T	M	A	L	L	A	R	M	E	T
M	A	B	U	S	E	H	A	N	E	T	
O	R	E	K	S	B	D	E	M	O	N	I
R	A	S	T	K	A	B	I	R	E	T	P
I	H	A	P	E	R	I	T	O	N	I	T
A	T	K	I	M	B	O	I	R	K		
R	A	S	A	P	A	G	A	N	T	I	N
T	A	V	E	R	R	A	D	O	M		
Y	M	A	R	S	T	A	N	E	T	J	
M	A	J	A	F	O	R	M	A			
H	A	R	A	K	I	R	I	E	R	I	T
A	S	T	I	R	A	D	A	M	E	S	
S	H	A	M	A	T	A	L	O	T	U	S

FJALËKRYQI (1)

FJALËKRYQI (2)

SUDOK

		9		4		7		
4				8		6	9	
			6		8			
5	9		4		7		2	
	1		5		8		4	
			3					
7				5	6		3	
								5
4		2				1		

Plotësoni vendet bosh në mënyrë që çdo kolonë të ketë numrat nga 1-9

Përgjigje e sudokut të numrit të kaluar

8	2	4	9	6	7	1	3	5
3	6	7	8	1	5	4	2	9
1	9	5	2	3	4	8	6	7
2	8	6	1	4	9	7	5	3
9	5	1	3	7	8	6	4	2
4	7	3	5	2	6	9	8	1
7	1	8	6	5	3	2	9	4
5	4	9	7	8	2	3	1	6
6	3	2	4	9	1	5	7	8

Argëtim filozofik

-Vdekja do jetë shumë e bukur nëse di të komunikosh me të . Eshhtë një shpërbërje , bie prapë në burimin e qënies për tu glodhur e për tu rinovuar . Do të thotë , të zhdukesh në burimin e ekzistencës dhe të bashkohesh me Zotin – dhe mund të rilindësh prapë , deri sa të bëhesh i Zgjuar

-Për të parë atë që pak njerëz kanë parë duhet të shkoni aty ku pak kanë qenë .

-Përgjuajesi është i ngjashëm me atë që hedh pluhur kundër dikujt tjetër kur era është në drejtim të tij ; kështu pluhuri s'bën gjë tjetër veçse i kthehet atij që e hodhi

Thënie të mençura

KRIPTOSKEME

KRIPTOSKEME

Përgjigja e numrit të djeshëm

K	U	L	T		14	4		9		7	4	19	M	A	S	H	U	R	K	A		I	R	A	K	
8	10	5			1	4	12	2	6	7	5	10	E	S	T	E	R	A		D	H	U	N	A		
10	4	7			4	1	2	8	10	6	4	7	5	I	T	E	A	T	E	R		M	I	N		
18					1	7	5	8	9	4	2	10	4	E	R	A		P	O	L	A	R		T	A	
6	5	1			6	2	10	5	2	5		12	K	E	L		P	O	L	E	M	I	K	A	T	
7	1				17	5		1	5	10	17	4	2	L		P	O	L	I	G	A	M	I			
2	5	10	17	4	2		4	10		6	15	5	E	T	A		P	I	K	A	T		R	E	L	
8		2	8	12			15		6	10	17	5	K	O	M	O		D	E	N		T	O	K	E	
18	10	5	16	19			6		4	8		10	1	T	R	I		S	E	T	M		N	U	N	
6		7	5			6	11	5		9	19	6	7	I	T		T	U	T	U		I	T	I	D	
4	11	4	7	6	2	6	1	5		7	17	6	K	A	D	E	T		K	O	S	H		L	E	
12	5	2	5			12	1	6	15	4	2		8	E	T	I	K		S	E	K	S	E	R	E	T

-I vrytshmi nuk mund të plagoset dhe dhimbja që tjerët duan t'i shkaktojnë , biemi vetë ato .

-Mos i beso asgjëje , s'ka rëndësi ku e ke dëgjuar ose kush e ka thënë , edhe sikur ta kem thënë unë , vetëm nëse është e pranueshme dhe e kuptueshme për arsyen tënde .

-Kush nuk ka plagë në dorë mundet të prekë helmin me atë dorë : helmi nuk penetron aty ku nuk ka plagë ; dhe nuk është mëkat (vepra) për ata që nuk e ka mëkat .

